



# USHTRIA



Viti i 73-të i botimit Nr. 27 (827675)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 10 korrik 2020

## Presidenti i Republikës, Ilir Meta:



### "Kalorës i Urdhrit të Flamurit", për atasheun ushtarak italian, Kolonel Cornacchia

Presidenti Ilir Meta dekoroi atasheun ushtarak italian, Kolonelin Fabio Cornacchia me titullin e lartë "Kalorës i Urdhrit të Flamurit", me motivacion vlerësimin e kontributit të çmuar për forcimin e urave të bashkëpunimit, me qëllim rritjen e kapaciteteve akademike dhe profesionale të ushtarakëve shqiptarë, sipas

standardeve euroatlantike. Me mirënjohje për zgjerimin dhe thellimin e bashkëpunimit midis dy vendeve dhe popujve miq. Në ceremoninë solemne të zhvilluar ditën e dielë, më 5 korrik 2020, ishin të pranishëm ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, ambasadori i Republikës së Italisë në Tiranë, Fabrizio Bucci...

»» faqe 2

## Presidenti i Republikës, Ilir Meta dekreton

### Gjeneral brigade Bajram Begaj merr gradën madhore "Gjeneral Major"



»» faqe 3

## Prezenca e Përparuar e Përforcuar e NATO-s

# Kontingjentit VII, EOD niset në misionin e NATO-s, në Letoni

21 efektivët e EOD, janë pjesë e grup-batalionit të udhëhequr nga forcat kanadeze në dislokuara në Letoni

»» faqe 3



## Baza Detare e Pashalimanit

### Forcat Detare, Forcat Ajrore dhe Forcat Speciale stërviten në Pashaliman

Baza Detare e Pashalimanit u shndërrua për rreth dy javë në teatrin më të madh stërvitor të Forcave të Armatosura për këtë vit. Efektivë nga katër kompanitë e Batalionit të Forcave Speciale, të mbështetur nga anijet e Forcës Detare dhe helikopterët e Forcës Ajrore, testuan dhe rritën me tej aftësitë dhe kapacitetet e tyre për t'u përballur me situata të ndryshme që mund kërcënojnë...



»» faqe 5

## Shkolla e Trupës në Bunavi

### Fillon periudha "blu" e stërvitjes Individuale Bazë

Rekrutët e rinj të Forcave të Armatosura përfunduan më 3 korrik 2020 periudhën "e gjelbër" të Stërvitjes Individuale Bazë në Shkollën e Trupës në Bunavi. Si asnjëherë më parë, i gjithë programi stërvitor po zhvillohet duke respektuar me përpikmëri masat kundër COVID-19. Në këtë fazë të parë të stërvitjes, vajzat dhe...

»» faqe 5



## Ministrja Shekerinska

### Gjatë tre viteve buxheti dhe rrogat për armatën janë rritur

»» faqe 11

## FORCA DETARE-PORTI I DURRËSIT

### Në anijen "Iliria" zhvillohet testimi i vetëdrejtimit të anijes

faqe 5

## HISTORI

### Veçori të Shtabit të Përgjithshëm gjatë LANÇ-it

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ  
faqe 15



Presidenti i Republikës, Ilir Meta:

# “Kalorës i Urdhrit të Flamurit”, për atasheun ushtarak italian, Kolonel Cornacchia

*“Vlerësim për kontribut të çmuar në forcimin e urave të bashkëpunimit, me qëllim rritjen e kapaciteteve akademike dhe profesionale të ushtarakëve shqiptarë sipas standardeve euroatlantike”.*

Presidenti Ilir Meta dekoroi atasheun ushtarak italian, Kolonelin Fabio Cornacchia me titullin e lartë “Kalorës i Urdhrit të Flamurit”, me motivacion vlerësimin e kontributit të çmuar për forcimin e urave të bashkëpunimit, me qëllim rritjen e kapaciteteve akademike dhe profesionale të ushtarakëve shqiptarë, sipas standardeve euroatlantike. Me mirënjohje për zgjerimin dhe thellimin e bashkëpunimit midis dy vendeve dhe popujve miq.

Në ceremoninë solemne të zhvilluar ditën e dielë, më 5 korrik 2020, ishin të pranishëm ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, ambasadori i Republikës së Italisë në Tiranë, Fabrizio Bucci, përfaqësues institucionesh dhe autoritete vendore, familjarë, miq dhe kolegë të atasheut ushtarak.

Në fjalën e tij, Presidenti Meta vuri në dukje kënaqësinë e veçantë të organizimit të një ceremonie solemne për të nderuar Kolonelin Cornacchia, ushtarak i një vendi partner strategjik të gjithanshëm, Italisë.

“Kolonel Cornacchia ka një përvojë të shkëlqyer, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në vende të tjera me forcat e NATO-s. Misioni i parë i tij në vendin tonë ka qenë në vitin 1999, gjatë Luftës së Kosovës, ku kontribuoi si pjesë e operacionit të forcave të NATO-s, për të përballuar krizën e refugjatëve në atë situatë të vështirë dhe historike. Ajo eksperiencë la gjurmë të forta në kujtesën e tij ndaj edhe kur iu ofrua mundësia të kthehej në Shqipëri rreth dy dekada më vonë si Atashe Ushtarak i Italisë gjë që e priti me shumë kënaqësi”, -u shpreh Meta.

Ai tha se gjatë këtyre viteve si Atashe Ushtarak në vendin tonë ai ka dhënë një kontribut të shkëlqyer për të forcuar bashkëpunimin shumë të mirë midis forcave ushtarake italiane dhe atyre shqiptare në të gjitha drejtimet.

“Sidomos lidhur me edukimin dhe formimin e ushtarakëve tanë në shkollat ushtarake italiane, stërvitjet dhe përgatitjet për operacione të përbashkëta të policisë ushtarake dhe karabinierisë, së fundmi edhe në fushën e shëndetësisë ushtarake. Në veçanti falenderojmë Kolonelin Cornacchia për angazhimin e tij në kohën e vështirë të pandemisë, për të lehtësuar procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve shqiptarë për ndjekjen e studimeve në fushën ushtarake në Itali. Profesionalizmi, korrektësia dhe komunikimi i tij i shkëlqyer me kolegët shqiptarë, por edhe të vendeve partnere, ndërveprimi dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me të gjitha institucionet shqiptare e kanë bërë Kolonelin Cornacchia një bashkëpunëtor mjaft të çmuar të Forcave të Armatosura të vendit tonë”, -nënvizoi Presidenti.

Ai shton se, “Pas 3 vitesh shërbim si atashe ushtarak, Kolonelin Cornacchia do të largohet nga Shqipëria për t’u kthyer në Itali. Por jam i sigurt se të dyja përvojat e tij në vendin tonë e kanë bërë një mik të pandashëm të Shqipërisë dhe jam i sigurt se gjithmonë do të jetë një mbështetës i marrëdhënieve tona, por edhe një promovues i të gjitha bukurive të Shqipërisë”.



“

*“Kolonel Cornacchia ka një përvojë të shkëlqyer, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në vende të tjera me forcat e NATO-s. Misioni i parë i tij në vendin tonë ka qenë në vitin 1999, gjatë Luftës së Kosovës, ku kontribuoi si pjesë e operacionit të forcave të NATO-s, për të përballuar krizën e refugjatëve në atë situatë të vështirë dhe historike”.*

”

*“Profesionalizmi, korrektësia dhe komunikimi i tij i shkëlqyer me kolegët shqiptarë, por edhe të vendeve partnere, ndërveprimi dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me të gjitha institucionet shqiptare e kanë bërë Kolonelin Cornacchia një bashkëpunëtor mjaft të çmuar të Forcave të Armatosura të vendit tonë”, - nënvizoi Presidenti.*

## Ekupazhi i Forcës Ajrore në një operacion kërkim-shpëtimi

Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka ndau ditën e hënë më 6 korrik 2020, pamje nga një operacion real kërkim-shpëtimi i realizuar nga ekupazhet e Forcës sonë Ajrore. “Kjo nuk është një stërvitje! Shikoni se si duket një operacion real kërkim-shpëtimi nga ekupazhet e Forcës sonë Ajrore, e parë nga këndvështrimi i operatorit të bordit”, -tha Xhaçka. Ministrja shprehu krenarinë për pilotët dhe teknikët e FA-së që jo në shumicën e rasteve, por gjithmonë, iu duhet të operojnë në kushte dhe terrene jashtëzakonisht të vështira, në mal, në borë, në përmytje, në det, etj.



STAFI

**DED KOLA**  
Shef i Sektorit të  
Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:  
Mimoza **GOLIKJA**

Gazetarë:  
Saimir **ALIJA**

Graphic Designer:  
Afërdita **HYSAJ**

ADRESA:  
Rruga e Dibrës/  
Garnizoni “Skënderbej”



# Prezenca e Përparuar e Përforcuar e NATO-s

## Kontingjenti VII, EOD niset në misionin e NATO-s, në Letoni

*21 efektivët e EOD, janë pjesë e grup-batalionit të udhëhequr nga forcat kanadeze në dislokuara në Letoni*

Në mjediset e Batalionit të Xhenios (bXh) të Komandës Mbështetëse, u zhvillua ditën e martë më 7 korrik 2020 ceremonia e nisjes së Kontingjentit VII, EOD, i cili do të marrë pjesë në misionin e Prezencës së Përparuar të Përforcuar (enhanced Forward Presence - eFP) të NATO, si pjesë e grup-batalionit të udhëhequr nga forcat kanadeze në dislokuara në Letoni.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast mori pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, i shoqëruar edhe nga komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ndrëçim Sallaku.

Në përshëndetjen e tij drejtuar trupave, gjeneral brigade Kollçaku, duke e konsideruar nder dhe privilegj përcjelljen e 21 efektivëve të EOD, në misionin e NATO në Letoni, theksoi se përcjellja e këtij kontingjenti për në Letoni vjen pas një periudhe të vështirë pandemie, por që vuri në sprovë dhe një herë gatishmërinë, profesionalizmin dhe disiplinën e hekurt të pjestarëve të Forcave të Armatosura.

"Këta djem dhe vajza do të vazhdojnë të kontribuojnë dhe ngrenë akoma më lart nderin, emrin dhe flamurin tonë duke ofruar kapacitetin EOD, i cili është konsideruar një kapacitet shumë i rëndësishëm mbështetës për grup-batalionin kanadez të dislokuar në Letoni"- u shpreh ai .

Më tej gjatë përshëndetjes së tij, gjeneral brigade Kollçaku vuri theksin në rëndësinë që ka bXh në ndërtimin e urave, pastrimin e hotspoteve si dhe rindërtimin pas tërmetit të 26 Nëntorit të vitit të kaluar.

Ceremonia vijoi me dorëzimin e flamurit për Kontingjentin VII, EOD, që niset në Letoni dhe u mbyll me një foto të përbashkët. Në misionin e FP të NATO në Letoni do të marrin pjesë 21 efektivë EOD, të cilët do të zëvendësojnë Kontingjentin VI, i cili pritet të kthehet këto ditë në atdhe.



### Akademia e Nënoficerit



### Zhvillohet stërvitja 24 orëshe "Çakalla 01-2020"

Kursi 65-të Fillestar i Nënoficerit në kuadër të programit mësimor, zhvilloi stërvitjen 24 orëshe kompaktësuese me temë "Çakalla 01-2020".

Nëpërmjet kësaj stërvitje kursantët morën njohuri mbi elementët themelorë të personalitetit të n/tetarit si drejtues në rol të komandantit të grupit dhe detyra të njehsuara me të, edukimi, përgjegjësimi ndaj detyrës dhe gadishmërisë luftarake në zbatimin e urdherave dhe disiplinës vetjake.

Stërvitja filloi me dhënien e urdherit luftarak për marshim dhe kryerjen e marshimit në këmbë sipas itinerarit të përcaktuar me ide taktike. Kursantët u përballën me situata të ndryshme si veprimet e grupit në patrullë zbulimi, veprimet e grupit për ngritjen e pikës së kontrollit dhe ngritja e vendndalesës, veprimet e grupit në mbrojtje, si dhe veprimet e grupit në sulm.

Stërvitja u inspektua nga grupi i inspektimit i kryesuar nga Komandanti i ANO-së. Grupi i inspektimit vlerësoi stërvitjen 24-orëshe dhe mënyren e veprimit të kursantëve gjatë gjithë zhvillimit të stërvitjes, situatave të ndryshme, si dhe gjatë ngritjes të fushimit.

### PRESIDENTI I REPUBLIKËS, ILIR META DEKRETON

## Gjeneral brigade Bajram Begaj merr gradën madhore "Gjeneral Major"

*Ka përfunduar studimet në Fakultetin e Mjekësisë në Degën Mjekësi e Përgjithshme në vitin 1989 dhe është titulluar oficer aktiv në specialitetin 'Mjekësi' në vitin 1998.*

*Aktualisht është me detyrë "Komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes"*

Presidenti i Republikës SHTZ, Ilir Meta, dekretoi me nr. 11535 datë.03.07.2020 dhënien e gradës madhore "Gjeneral Major" për Gjeneral Brigadë Bajram Rushit Begaj, me detyrë "Komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes".

Gjeneral Major Bajram Begaj, ka lindur në datë 20.03.1967, në Rrogozhinë. Ka përfunduar studimet në Fakultetin e Mjekësisë në Degën Mjekësi e Përgjithshme në vitin 1989 dhe është titulluar oficer aktiv në specialitetin "Mjekësi" në vitin 1998.

Gjeneral major Begaj, ka përfunduar "Doktoraturën në Fushën e Mjekësisë", në Shqipëri si dhe mban titullin Profesor i asociuar në Mjekësi.Gjatë karrierës 31 vjeçare ushtarake ka kryer, Kursin e Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen; Shkollën e

thelluar pasuniversitare të mjekësisë, specializimin pasuniversitar në profilin Gastrohepatologji, kursin e menaxhimit spitalor dhe kursin e lidershipit mjekësor strategjik, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës si dhe kursin specializimit në fushën e mjekësisë dhe kursin e shëndetësisë, në Greqi.

Aktualisht Gjeneral Major Begaj mban postin e Komandantit të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes në Forcat e Armatosura, ndërkohë që në 31 vitet e karrierës në FA ka mbajtur një sërë detyrash mes të cilave: shef i Njësisë Mjekësore Ushtarake dhe zëvendësudrejtor Ushtarak i SUT, drejtor i Spitalit Ushtarak, drejtor i Inspektoratit Shëndetësor dhe Kryeinspektor dhe Këshilltar i Inspektoratit Shëndetësor në Shtabin e Përgjithshëm Ushtarak Qendror Universitar etj.





## QENDRA E PERSONEL REKRUTIMIT-TIRANË

# Aplikoni për 250 kandidatë ushtarë/detarë në 12 specialitete

*Ja specialitetet: Muzikant, kuzhinier, infermieri, ndërlidhje, polici ushtarake, këmbësori, MZ, shofer, mirëmbajtje, motorist, xhenio dhe Roje. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë QPR është deri në 10 korrik 2020*

Qendra e Personel Rekrutimit, pranë Ministrisë së Mbrojtjes ka filluar më 1 Qershor 2020, regjistrimin e kandidatëve për ushtarë/detarë aktiv dhe kërkon të rekrutojë për periudhën 24 gusht- 30 tetor 2020, gjithsej 250 kandidatë, sipas rajoneve: Tiranë 120, Shkodër 40, Lezhë 4, Durrës 16, Vlorë 7, Berat 39, Elbasan 5, Burrel 1, Kukës 1, Gramsh 5 dhe Poliçan 12. Kurse 250 kandidatët gjithsej, do të shpërndahen në 12 specialitete si: Ndërlidhje 15, Polici Ushtarake 10, Këmbësori 82, MZ 2, Shofer 37, Mirëmbajtje 9, Kuzhinier 2, Motorist 1, Xhenio 2, Infermieri 11, Roje 76 dhe Muzikant 3. Afati për dorëzimin e dokumentacionit pranë QPR-së është deri në 10 korrik 2020.

## Kriteret e pranimit të kandidatëve

Të jetë shtetas shqiptar; të mos jetë dënuar nga gjykata për vepra penale; të mos jetë në ndjekje penale; të mos jetë në proces gjykim penal nga gjykata; të ketë figurë të pastër morale; të mos ketë probleme me deportimin; të mos ketë probleme me drogën dhe alkolin; të mos jetë person i dyshuar, i padëshirueshëm, i evidentuar dhe i implikuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundraligjshme apo kriminale; mosha minimale e rekrutimit është 18 vjeç. Në momentin e titullimit ushtarë/detarë aktiv nuk duhet të kenë mbushur moshën 27 vjeç. Përjashtim bëjnë vetëm shtetasit që do të titullohen ushtar/detar aktiv, të cilët do të jenë personel mjekësor i Forcave të Armatosura dhe në momentin e titullimit nuk duhet të kenë mbushur moshën 32 vjeç; të kenë kryer arsimin parauniversitar apo të lartë brenda ose jashtë vendit; të kenë gjatësinë trupore mbi 165 cm për meshkujt dhe mbi 160 cm për femrat; të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurrimit; të ketë kryer kontrollin shëndetësor dhe të jetë vlerësuar i aftë për ushtarë/detarë aktiv nga Komisioni Mjekësor Ushtarak; të ketë rezultuar pa probleme gjatë verifikimit të kushtit të sigurisë të kryer nga strukturat përgjegjëse.

## Procedura e aplikimit për ushtarë/detarë aktiv

Shtetasit që dëshirojnë të shërbejnë në Forcat e Armatosura si ushtarë/detarë aktiv, do të aplikojnë drejtpërdrejtë në zyrën e pranimit në Qendrën e Personel Rekrutimit. Aplikantët plotësojnë formularin e aplikimit, pranimit dhe marrin njoftimin për dokumentet e nevojshme, kuotat e rekrutimit, specialitetet, rajonet e rekrutimit, afatin e paraqitjes në Qendrën e Personel Rekrutimit për vijimin e procesit të pranimit, testimin e përzgjedhjes, etj.



## Regjistrimi i kandidatëve, dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim në QPR

Kandidatët për ushtarë/detarë aktiv paraqesin në Qendrën e Personel-Rekrutimit, dokumentet e mëposhtme: a) Dokumentacioni që do të paraqesin kandidatët në fazën e regjistrimit është: Kërkesë me shkrim, në të cilën parashtrohet identiteti i aplikantit, statusi familjar (martuar, beqar), arsyet për të cilat dëshiron të bëhet ushtarë/detarë aktiv, si dhe jo më pak se dy mundësi zgjedhje për njësinë apo repartin në të cilin do të dëshironte për të shërbyer. Aftësitë,

përvoja në punë, prirjet e tij në fusha të caktuara, (formulari i aplikimit); fotokopjen e kartës së identitetit; çertifikatë familjare, 1 copë, e cila gjenerohet online nga QPR-ja në bashkëpunim me DMBNJ&SH, në portalin e-albania, sipas akteve ligjore në fuqi; dy fotografi të përmasave 4 x 6cm dhe dy fotografi të përmasave 9x12 cm; fotokopje të diplomës së arsimit parauniversitar të noterizuar dhe çertifikatën e maturës shtetërore të vërtetuar nga Drejtoria Arsimore rajonale/rrethit, e noterizuar ose të arsimit të lartë të noterizuar; diplomë, dëshmi, çertifikatë për aftësitë profesionale (nëse ka), për drejtim automjeti, për njohje të gjuhës angleze,

të noterizuara; raportin mjekësor të lëshuar nga mjeku i familjes në qendrën shëndetësore të vendbanimit, ku deklarohet se kandidati është i aftë për punë; ekzaminimet mjekësore për agjentët infektiv (Hepatit B, Hepatit C, HIV/AIDS, Sifiliz) dhe grupin e gjakut të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe/ose bankat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethet ku banojnë. Në momentin e aplikimit pranë zyrës së pranimit në Qendrën e Personel Rekrutimit, kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit për ushtarë/detarë aktiv, si dhe formularët e vetëdeklarimit.

## Dokumentacioni që do të paraqesin kandidatët e kualifikuar pas përfundimit të testimit

Nëse kandidati shpallet fitues, brenda 2(dy) javëve duhet të sjellë në QPR edhe dokumentacionin e mëposhtëm: dëshmi penaliteti; vërtetim nga prokuroria; vërtetim nga gjykata; raportin mjekësor të lëshuar nga Komisioni Mjeko-Ligjor (KML) në Njësinë Mjekësore Ushtarake. Qendra e Personel Rekrutimit, në bashkëpunim me strukturat që kanë akses në portalin "e-albania", të sigurojë dokumentacionin, i cili mund të shkarohet online nëpërmjet portalit qeveritar "e-albania", sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kandidatët të sigurojnë vetë dokumentacionin e kërkuar, vetëm në rastet kur për arsye teknike ai nuk mund të shkarohet nëpërmjet portalit. Qendra e Personel-Rekrutimit vijon procedurat e testimit dhe përzgjedhjes vetëm me kandidatët të cilët kanë paraqitur dokumentacionin sipas kriterëve të mësipërme.

*Shënim: Dokumentacioni i aplikantit i plotësuar pranë Qendrës së Personel Rekrutimit nga aplikanti, së bashku me dokumentacionin e dorëzuar prej tij, është pjesë e pandarë e dosjes personale të kandidatit për ushtar/detarë aktiv.*



## BAZA DETARE E PASHALIMANIT

# Forcat Detare, Forcat Ajrore dhe Forcat Speciale stërviten në Pashaliman

*Në Ditën e Vizitorëve të Shquar ishte i pranishëm edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku*

**B**aza Detare e Pashalimanit u shndërrua për rreth dy javë në teatrin më të madh stërvitor të Forcave të Armatosura për këtë vit. Efektivë nga katër kompanitë e Batalionit të Forcave Speciale, të mbështetur nga anijet e Forcës Detare dhe helikopterët e Forcës Ajrore, testuan dhe rritën me tej aftësitë dhe kapacitetet e tyre për t'u përballur me situata të ndryshme që mund kërcënojnë sigurinë dhe paqen.

Gjatë stërvitjes dyjavore, trupat e Forcave Speciale improvizuan skenarë të ndryshëm, në tokë dhe në det. Ndërhynë nga toka duke goditur dhe kontrolluar mjete dhe të dyshuar për transport të lëndëve plasëse, testuan aftësitë e bordingut duke u infiltruar nga ajri dhe deti në një anije të dyshuar, goditën elementë kriminalë dhe terroristë me anë të zbarkimit nga deti si dhe rritën kapacitetet e zhytësve të Batalionit Special.

Në Ditën e Vizitorëve të Shquar të kësaj stërvitjeje ishte i pranishëm edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, i cili shoqërohej nga komandantët e forcave kryesore.

Gjeneral brigade Kollçaku e vlerësoi si shumë të rëndësishëm bashkëpunimin mes tre forcave duke i përgëzuar jo vetëm për aftësitë e treguara gjatë stërvitjes, por edhe për angazhimin e tyre gjatë periudhës së pandemisë.

Më tej, shefi i Shtabit i siguroi trupat pjesëmarrës në stërvitje dhe gjithë ushtarakët shqiptarë për përmirësimin e kushteve të punës dhe stërvitjes, modernizimin e FA me armatim, mjete dhe pajisje, pa harruar trajtimin financiar të tyre.

Stërvitja e Forcave Speciale në Pashaliman, në bashkëpunim me Forcën Detare dhe atë Ajrore është e para e këtij niveli për të këtë vit në Forcat e Armatosura, të cilat kanë qenë të angazhuara në përballimin e pasojave të shkaktuara nga pandemia.



*Gjeneral brigade Kollçaku e vlerësoi si shumë të rëndësishëm bashkëpunimin mes tre forcave duke i përgëzuar jo vetëm për aftësitë e treguara gjatë stërvitjes, por edhe për angazhimin e tyre gjatë periudhës së pandemisë.*

## Kremtohet 89 vjetori i krijimit të Armës së Mbrojtjes Kundërajrore

Më datë 1 korrik 2020, në ambjentet e garnizonit të Rinasit, u zhvillua ceremonia me rastin e kremtimit të 89 vjetorit të krijimit të Armës së Mbrojtjes Kundërajrore. Në këtë ceremoni Zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore kolonel Editson Zarka falenderoi ushtarakët që kanë shërbyer në këtë armë. Në përfundim të ceremonisë kolonel Zarka, dorëzoi "Medalje karriere", për personelin.



### FORCA DETARE-PORTI I DURRËSIT

## Në anijen "Iliria" zhvillohet testimi i vetëdrejtimit të anijes

Gjatë paraditës të datës 1 korrik 2020, në anijet e klasit "Iliria" në Portin e Durrësit u zhvillua testimi për vetëdrejtimin e anijes. Testimi u zhvillua në dy faza teorike dhe praktike. Në testim morën pjesë 8 oficer!

Testimet u ndonjën nga Shefi i Shtabit të Forcës Detare kapiten i rangut të dytë Sabri Gjinollari dhe Shefi i Degës Operacioneve dhe Stërvitjes kapiten i rangut të parë Engjell Sinanaj. Testimi praktik u zhvillua në det duke zbatuar



disa skenarë ku u testuan aftësitë e Komandantëve dhe efektivave për drejtimin e sigurt të anijes.

Skenarët që u zhvilluan ishin dhënie ndihme njeriu në det, drejtimi i anijes në kushte të avarive të ndryshme në anije, lufta kundra zjarrit dhe ujit, mbrojtja e afërt e anijes etj.

Prioritet i Forcës Detare/ Rojes Bregdetare ishte zbatimi i misionit të saj si dhe detyrat kryesore ku një rëndësi të veçantë ka dhënia e ndihmës dhe shpëtimin i jetëve në det. Kjo merr edhe një rëndësi të veçantë gjatë sezonit turistik ku dhe fluksi i aktivitetit në det është në rritje.

### SHKOLLA E TRUPËS NË BUNAVI

## Fillon periudha "blu" e stërvitjes Individuale Bazë

*Rekrutët e rinj të Forcave të Armatosura përfunduan më 3 korrik 2020 periudhën "e gjelbër" të Stërvitjes Individuale Bazë në Shkollën e Trupës në Bunavi. Si asnjëherë më parë, i gjithë programi stërvitor po zhvillohet duke respektuar me përpikmëri masat kundër COVID-19*

Në këtë fazë të parë të stërvitjes, vajzat dhe djemtë janë njohur me rregullat dhe njohuritë fillestare për Forcat e Armatosura.

Me përfundimin e fazës së parë ka nisur edhe faza e dytë, ajo "blu", e cila thëllon njohuritë dhe përgatitjen e rekrutëve përpara se ata t'i nënshtrohen periudhës më të vështirë.

Periudha e fundit, e ashtuquajtur "e kuqe", do të jetë

sprova e vërtetë e rekrutëve të rinj, para se ata të titullohen e betohen si ushtarë të Forcave të Armatosura. Periudha "e kuqe", kërkon nga rekrutët të tregojnë përgatitje të lartë fizike dhe sidomos psikologjike.

Stërvitja Individuale Bazë ka qëllim transformimin gradual të qytetarëve për rreth 11 javë nga civilë në ushtarë profesionistë të Forcave të Armatosura.





## QENDRA E PERSONEL REKRUTIMIT SHPALL APLIKIMET

# Studime (2 kandidatë) në Institucionet Ushtarake të Kosovës

*Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit në Qendrën e Personel Rekrutimit pranë Ministrisë së Mbrojtjes, në Tiranë, është deri në 6 korrik 2020. Krahas testeve që do zhvillohen nga Qendra e Personel Rekrutimit në Tiranë, kandidatët fitues do të testohen edhe nga Qendra për Studime Universitare në Kosovë*

Qendra e Personel Rekrutimit, me 21 maj ka shpallur kriteret për rekrutimin e 2 kandidatëve për studime në Qendrën e Studimeve Universitare, në Kosovë. Studimet ushtarake ndiqen pranë Qendrës për Studime Universitare të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe studimet e larta universitare në Institutin Rochester të Teknologjisë, në Kosovë. Ndërsa afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri në 6 korrik 2020.

## Kriteret e pranimit të kandidatëve

Të ketë shtetësi shqiptare. Të ketë kryer arsimin parauniversitar brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë ose në raste të veçanta të jetë në vitin e fundit të studimeve parauniversitare. Të mos jetë i dënuar apo i ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë. Të jetë në moshë jo më pak se 18 vjeç dhe jo më shumë se 21 vjeç, në datën e aplikimit. Të mos jetë i martuar. Të jetë i aftë nga ana shëndetësore. Të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm nga të gjitha pikëpamjet, pa asnjë mangësi apo shenja që deformojnë pamjen si dhe të mos ketë tatuazhe në pjesët e dukshme të trupit. Të ketë gjatësinë trupore jo më pak se 170 cm për meshkujt dhe jo më pak se 165 për femrat. Të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (Sëmundje Seksualisht të Transmetueshme); të mos ketë kaluar apo të vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zemrës, veshkave, hepaticke, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe lëvizjes) apo të ketë qenë ose të jetë përdorues i lëndëve narkotike.

Kandidatët që do të aplikojnë për ndjekjen e studimeve në Qendrën e Studimeve Universitare të Kosovës të plotësojnë kriterin e notës mesatare të shkollës parauniversitare, mbi 7 (shtatë). Të jenë njohës të mirë të gjuhës angleze (kandidatët do të testohen nga MFSK në testimin gjuhësor TOEFL). Kandidatët nuk mund të regjistrohen për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit, në rast se: zotërojnë diplomë ushtarake për nivelin arsimor për të cilin aplikojnë; kanë fituar më parë statusin e studentit ushtarak; kanë qenë kontingjent i Forcave të Armatosura për ndjekjen e studimeve ushtarake brenda dhe jashtë vendit dhe nuk i kanë përfunduar studimet. Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përmendura më sipër, s'kualifikohet.

## Dokumentet për regjistrim

Kandidatët për regjistrim duhet të paraqesin pranë Zyrës së Pranimit Tiranë dokumentacionin e mëposhtëm:



Kërkesë me shkrim e nënshkruar nga kandidati për ndjekjen e studimeve në Qendrën e Studimeve Universitare të Kosovës. Formular me të dhënat personale sipas formatit të përcaktuar, Aneksi A. Fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimit përkatës së bashku me certifikatën dhe listën e notave. Fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar që vërteton se ndjek vitin e fundit të studimeve parauniversitare si dhe listën e notave të vitit të parë, vitit të dytë dhe semestrin aktual. Fotokopje e kartës së identitetit. Fotografji për dokument (4x6), 2 (dy) copë. Fotokopje të pasaportës e vlefshme për jashtë shtetit. Raport mjekësor të lëshuar nga

mjeku i familjes i qendrës shëndetësore të vendbanimit. Ekzaminimet mjekësore për agentë infektiv (Hepatit B, Hepatit C, HIV/AIDS, Sifiliz) dhe grupin e gjakut të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe/ose bankat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethet ku banojnë. Formularët e vetëdeklarimit, të cilët plotësohen pranë Qendrës së Personel Rekrutimit në momentin e dorëzimit të dokumentacionit.

## Dokumentacioni që duhet të paraqesin pas përfundimit të testimit

Dokumentacioni që duhet të

paraqesin kandidatët e kualifikuar pas përfundimit të testimit, brenda 5 ditëve: Dëshmi penaliteti. Vërtetim nga gjykata që nuk është në proces gjyqësor. Vërtetim nga prokuroria që nuk është në proces hetimi. Vërtetim nga përmbartimi. Raportin mjekësor të lëshuar nga Komisioni Mjeko-Ligjor (KML) i Njësisë Mjekësore Ushtarake.

## Datat e testimit

Testimi i gjuhës së huaj (Anglisht) do të zhvillohet më datë 7.7.2020, testi fizik do të zhvillohet më datë 7.7.2020, testi intelektual do të zhvillohet më datë 8.7.2020, testi psikologjik do të zhvillohet më datë

8.7.2020. Krahas testeve të zhvilluara nga Qendra e Personel Rekrutimit në Tiranë, kandidatët do të testohen edhe nga Qendra për Studime Universitare në Kosovë, si dhe do të nevojitet dokumentacion për aplikim, për kandidatët e shpallur fitues në teste, si vijon: testimet që do të zhvillohen: testim matematik dhe gjuhësor (TOEFL); testim për udhëheqje/drejtim dhe testim i javës "zero".

## Dokumentacioni për aplikim për kandidatët që do të shpallen fitues

Për kandidatët që do të shpallen fitues duhet dokumentacioni: diploma e shkollës së mesme së bashku me certifikatën dhe listën e notave; certifikatë lindje; kopje e kartës së identitetit/pasaportës dhe dy fotografi të formatit 5x5 cm.

## Deklaruesi duhet të deklarojë me vullnetin e tij të lirë

Deklaruesi duhet të deklarojë me vullnetin e tij të lirë se: Jam: i/e padënuar apo i/e dënuar. Jam pa procedim penal në ngarkim apo me procedim penal në ngarkim. Jam pa proces penal në ngarkim apo me proces penal në ngarkim. Jam i/e pa gjykuar/padënuar jashtë vendit apo i/e gjykuar/dënuar jashtë vendit dhe jam i/e padetyrime përmbartimore apo i/e me detyrime përmbartimore.



**Q**endra e Personel Rekrutimit, kërkon të rekrutojë studentë për studime ushtarake në shkollat e larta ushtarake të Greqisë, 4 (katër) të drejta studimi si më poshtë vijon:

Akademia Ushtarake e Forcave Tokësore "Evelpidon", specialiteti gjithëarmësh, 1 (një) kuotë, Akademia Ushtarake e Forcave Detare, (SND), 1 (një) kuotë, Shkolla Ushtarake e Oficerëve të Trupës, në mjekësi, 1 (një) kuotë. Shkolla Oficerëve të Infermierisë "SAN", 1 (një) kuotë. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë QPR është më 14 korrik 2020.

#### Kriteret e pranimit të kandidatëve:

Të ketë shtetësi shqiptare, të ketë kryer arsimin parauniversitar brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë ose në raste të veçanta të jetë në vitin e fundit të studimeve parauniversitare, të mos jetë i dënuar apo i ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë.

Të jetë në moshë jo më pak se 18 vjeç dhe jo më shumë se 22 vjeç, në ditën e fillimit të vitit akademik. Të mos jetë i martuar, të jetë i aftë nga ana shëndetësore, të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm nga të gjitha pikëpamjet, pa asnjë mangësi apo shenja që deformojnë pamjen si dhe të ketë bërë të gjitha vaksinat dhe të mos jetë mbartës i sëmundjeve ngjitëse, të ketë gjatësinë trupore jo më pak se 170 cm për meshkujt dhe jo më pak se 165 për femrat. Të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (Sëmundje Seksualisht të Transmetueshme) të tjera; të mos ketë kaluar apo të vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zemrës, veshkave, hepatike, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe lëvizjes) apo të ketë qenë ose jetë përdorues i lëndëve narkotike.

Kandidatët që do të aplikojnë për ndjekjen e studimeve në Shkollat e Larta Ushtarake të Greqisë të plotësojnë kriterin e notës mesatare të shkollës parauniversitare, jo më pak se 6.5 (gjashtë pikë pesë). Të jenë njohës i mirë i gjuhës angleze dhe niveli i saj duhet të jetë të paktën "B2" ose mbi 60 pikë në ELPT. Kandidati që do të jetë pjesë e Akademisë Ushtarake të Forcave Detare "SND" duhet të njohë shumë mirë notin.

Kandidatët nuk mund të regjistrohen për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit, në rast se: Zotërojnë diplomë ushtarake për nivelin arsimor për të cilin aplikojnë; kanë fituar më parë statusin e studentit ushtarak; kanë qenë kontingjent i Forcave të Armatosura për ndjekjen e studimeve ushtarake



## Qendra e Personel Rekrutimit shpall aplikimet

# Studime (4 kandidatë) në Shkollat e Larta Ushtarake të Greqisë

*Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë QPR është më 14 korrik 2020*



brenda dhe jashtë vendit dhe nuk i kanë përfunduar studimet. Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përmendura më sipër, s'kualifikohet.

#### Dokumentet për regjistrim:

Kandidatët për regjistrim duhet të paraqesin pranë Zyrës së Pranimit Tiranë, dokumentacionin e mëposhtëm: Kërkesë me shkrim e nënshkruar nga kandidati për ndjekjen e studimeve në

Shkollat e Larta Ushtarake të Greqisë. Formular me të dhënat personale sipas formatit të përcaktuar, Aneksi A. Fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimit përkatës së bashku me certifikatën dhe listën e notave. Fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar që vërteton se ndjek vitin e fundit të studimeve parauniversitare si dhe listën e notave të vitit të parë, vitit të dytë dhe semestrin aktual (në

momentin e testeve duhet të sjellë certifikatën dhe listën e notave (të fotokopjuar dhe noterizuar). Fotokopje e kartës së identitetit. Fotografji për dokument (4x6), 2 (dy) copë. Fotokopje të pasaportës e vlefshme për jashtë shtetit. Raport mjekësor të lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shëndetësore të vendbanimit. Ekzaminimet mjekësore për agjentë infektiv (Hepatit B, Hepatit C, HIV/AIDS, Sifiliz) dhe

grupin e gjakut të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe/ose bankat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethet ku banojnë. Formularët e vetëdeklarimit, të cilët plotësohen pranë Qendrës së Personel Rekrutimit në momentin e dorëzimit të dokumentacionit. Dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët e kualifikuar pas përfundimit të testimit, brenda 5 ditëve: Dëshmi penaliteti, vërtetim nga gjykata që nuk është në proces gjyqësor, vërtetim nga prokuroria që nuk është në proces hetimi, vërtetim nga përmbartimi, raportin mjekësor të lëshuar nga Komisioni Mjeko - Ligjor (KML) i Njësisë Mjekësore Ushtarake.

#### Datat e testimit:

Testi i gjuhës së huaj (Anglisht) do të jetë në datën 15.07.2020. Testi fizik do të jetë në datën 15.07.2020, Testi intelektual do të jetë në datën 16.07.2020 dhe testi psikologjik do të jetë në datën 16.07.2020

Deklaruesi duhet të deklarojë me vullnetin e tij të lirë se: Jam: i/e padënuar apo i/e dënuar. Jam: pa procedim penal në ngarkim apo me procedim penal në ngarkim. Jam pa proces penal në ngarkim apo me proces penal në ngarkim. Jam i/e pa gjykuar/padënuar jashtë vendit apo i/e gjykuar/dënuar jashtë vendit dhe jam i/e padetyrime përmbartimore apo i/e me detyrime përmbartimore.



NATO NË KONFERENCËN E OSBE-së

# NATO adreson kërcënimet e natyrës hibride

Më shumë se 100 pjesëmarrës të niveleve të larta, ministra dhe zëvendësministra u ftuan nga Kryesia shqiptare e OSBE-së për të shkëmbyer praktikën më të mirë dhe mësimet e marra në konferencën virtuale "Qeverisja e mirë dhe lufta kundër korrupsionit në epokën dixhitale", më 6 dhe 7 korrik 2020. Zëvendës Ndhmës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s për Operacionet, Jonathan Parish ndau përvojën e NATO-s mbi ndikimin e korrupsionit në stabilitetin dhe sigurinë.

Morën pjesë përfaqësues nga shtetet pjesëmarrëse të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), partnerë, organizata ndërkombëtare, akademi dhe shoqëri civile. Veprimtaria u organizua nën Kryesinë shqiptare të vitit 2020, e cila ka vendosur anti-korrupsionin në krye të axhendës së OSBE-së.

Dita e parë adresoi tema kryesore siç janë ndikimi në luftimin e korrupsionit dhe forcimi i qeverisjes së mirë mbi sigurinë, stabilitetin dhe rritjen ekonomike. Pjesëmarrësit diskutuan gjithashtu rolin e teknologjive dixhitale dhe inovacionin në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

Dita e dytë theksoi rolin e informuesve, media dhe shoqëria civile në luftimin e korrupsionit. Gjithashtu u



shqyrtua bashkëpunimi ndërkombëtar policor në hetimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit, duke nënvizuar rolin thelbësor të veprimit të zbatimit të ligjit drejt rimëkëmbjes së pasurive.

## Ndërtimi i integritetit

Zëvendës Ndhmës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jonathan Parish, shpjegoi se si NATO adreson kërcënimet e natyrës hibride si kor-

rupsioni dhe keqmenaxhimi i burimeve, përfshirë përmes zbatimit të Politikës së Ndërtimit të Integritetit të NATO-s, të miratuar në Samitin e Varshavës në 2016. Ai theksoi se

avancimi i një kulture të integritetit brenda sektorit të mbrojtjes dhe të ndërlidhur të sigurisë, si dhe praktikën, sistemet dhe mekanizmat e mira në vend, ndihmojnë në trajtimin e praktikave korruptive, institucionale dhe personale. "Paqja e vetë-mbajtjes është më pak e mundshme kur mungon integriteti, transparenca dhe përgjegjësia," shtoi ai.

Nisma e Ndërtimit të Integritetit të NATO-s (BI) kontribuon në sigurinë e NATO-s, si dhe përpjekjet e saj për të projektuar stabilitetin në zonën euro-atlantike dhe më gjerë. Nisma u filloi në vitin 2007 në kuadrin e programit të Partneritetit për Paqen të NATO-s. Ajo u siguron aleatëve të NATO-s dhe vendeve partnere mjete diagnostikuese dhe mbështetje të përshtatur për të forcuar parimet dhe praktikën e qeverisjes së mirë, dhe zvogëlon rrezikun e korrupsionit në sektorin e mbrojtjes dhe të sigurisë. Politika e BI e NATO-s dhe Plani i veprimit, pasues i BI-së mbulojnë strukturat civile, ushtarake dhe agjencitë e NATO-s.

## Polonia jep ndihmë shtesë mjekësore në Irak

Më 5 korrik 2020, Zyra e Presidentit të Republikës së Polonisë dhuroi 1000 litra dezinfektues për autoritetet shëndetësore të Irakut, si përgjigje ndaj pandemisë globale COVID-19. Ky donacion i dytë pasoi një kontribut të mëparshëm polak prej 50,000 maska të dhëna në 16 qershor.

Kontigjenti polak në Misionin e NATO-s Irak (NMI) koordinoi këtë shpërndarje shtesë të ndihmës. Ceremonia për të shënuar dhurimin e dytë polak u zhvillua në bazën ushtarake irakiane në Taji ku ishin të pranishëm, zyrtarë të lartë civilë dhe ushtarake irakene, përfaqësues polakë dhe personel të Misionit të NATO-s Irak dhe të Task Forces të Kombinuar të Operacionit të udhëhequr nga SHBA.

Iraku kërkoi ndihmë përmes Qendrës së Koordinimit Euro-Atlantik të NATO-s për Reagimin e Fatkeqësive (EADRCC). EADRCC është mekanizmi kryesor i NATO-s për reagimin ndaj urgjencave civile. Qendra operon mbi bazën 24/7, duke koordinuar kërkesat dhe ofertat e ndihmës. Që nga fillimi i krizës, EADRCC ka koordinuar kërkesa nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Koordinimin e Çështjeve Humanitare (OCHA), 16 vende të NATO-s dhe vende partnere, duke rezultuar në dhjetëra oferta ndihme.

NATO nisi Misionin e saj aktual në Irak në vitin 2018, me kërkesën e Irakut dhe pas vendimit nga drejtuesit e NATO-s në Samitin e Brukselit. Misioni i NATO-s Irak është një mision këshillues, trainues dhe



ndërtimit të kapaciteteve jo-luftarake, i kryer në respekt të plotë të sovranitetit dhe integritetit territorial të Irakut. Ai përfshin trajnerë, këshilltarë dhe personel ndihmës nga aleatët dhe vendet partnere, përfshirë Australinë, Suedinë dhe Finlandën. Ky Mision bazohet në arrijtjet e deritanishme të partneritetit midis NATO-s dhe Irakut.

Iraku dhe NATO gjithashtu ndajnë një angazhim të përbashkët në luftën kundër terrorizmit. Më 4 qershor 2020, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg mori pjesë në një takim të ministrave të Jashtëm të Koalicionit Global për të mposhtur ISIS-in, të mbajtur përmes video-konferencës. Ai deklaroi në atë kontekst se NATO

mbetet e vendosur plotësisht për të mbështetur "Forcat e vetë-mbajtjes së Sigurisë Irakiane, të afta të parandalojnë kthimin e Daesh, të stabilizojnë vendin e tyre dhe të luftojnë terrorizmin". Sekretari i Përgjithshëm vuri në dukje gjithashtu rëndësinë e ecjes përpara në koordinim të ngushtë dhe konsultime me Koalicionin Global dhe qeverinë e Irakut.

Në takimet e tyre të fundit të mbajtura përmes video-konferencës në 17 dhe 18 qershor 2020 ministrat e Mbrojtjes të NATO-s ripohuan angazhimin e tyre për të forcuar përpjekjet e Aleancës në Irak, në konsultim të plotë me qeverinë e Irakut dhe Koalicionin Global.

## Shkenca dhe Teknologjia në mbrojtje të sigurisë së Aleancës

Laboratori i NATO-s, Qendra për Kërkime dhe Eksperimente Detare (CMRE), me qendër në La Spezia, Itali, po ndihmon shtetin amerikan të Konektikutit në trajtimin e bllokimit të COVID-19.

Në bashkëpunim me Universitetin e Konektikutit (UConn), CMRE ka zhvilluar një aftësi modelimi për të parashikuar përhapjen e COVID-19. Shkencëtarët e Qendrës dhe profesorët e Universitetit janë duke kontribuar në punën e Akademisë së Shkencave dhe Inxhinierisë së Akademisë së Konektikutit, e cila po këshillon Guvernatorin e Konektikutit për strategjitë për të "rihapur" shtetin.

Ky bashkëpunim përdor modelet e CMRE për parashikimet e sakta të pozicioneve të ardhshme të një anijeje, të cilat zakonisht përdoren për të zbuluar

sjellje anomale që shoqërohen me aktivitete të paligjshme në det. Teknikat matematikore prapa këtyre modeleve janë të ngjashme me ato të përdorura për të përshkruar modelet e sjelljes përhapjen e viruseve. Shkencëtarët e CMRE janë në gjendje të adaptojnë njohuritë e tyre dhe të zbatojnë atë në parashikimin e përhapjes së COVID-19. Metodat e tyre u vërtetuan duke përdorur të dhëna nga Italia dhe Shtetet e Bashkuara. Shkencëtarët e NATO-s CMRE dhe UConn tani janë në proces të publikimit të një botimi shkencor që do të krahasojë performancën e qasjes së tyre ndaj modeleve standarde.

"Qendra e NATO-s këtu në Itali ka shkencëtarë të klasit botëror, të cilët mund të zbatojnë ekspertizën e tyre në fusha të reja të shkencës dhe të ndihmojnë Aleatët në luftimin e përhapjes së koronavirusit," tha Dr. Catherine Warner, Drejtore e Qendrës së NATO-s për Kërkime dhe Eksperimente Detare.

CMRE është një strukturë udhëheqëse e kërkimit shkencor dhe eksperimentimit që organizon dhe kryen kërkime shkencore dhe zhvillim teknologjik, të përqendruar në fushën detare, duke ofruar zgjidhje inovative të Shkencës dhe Teknologjisë për të adresuar nevojat e mbrojtjes dhe të sigurisë së Aleancës.





Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s

# Mircea Geoana: SHBA mbetet e përkushtuar për sigurinë në Europë

*Shtetet e Bashkuara po udhëheqin një grup beteje në Poloni dhe është e pranishme në vendet e tjera evropiane përfshirë Rumaninë dhe Norvegjinë*

Duke folur në një panel diskutimi virtual në Konferencën vjetore Transatlantike të organizuar nga Shkolla e Harvard Kennedy më 2 korrik 2020, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Mircea Geoană tha se COVID-19 ka përshpejtuar transformimin në shumë fusha dhe se Aleatët po nxjerrin mësim nga kjo krizë së bashku. Duke përmendur që NATO është përshtatur vazhdimisht në një botë në ndryshim, Z. Geoană tha se tani NATO po përshtatet edhe një herë në mënyrë që të përbushë një sërë kërcënimesh globale.

Ai theksoi se fakti që Shtetet e Bashkuara po udhëheqin një grup beteje në Poloni dhe është i pranishëm në vendet e tjera evropiane përfshirë Rumaninë, Norvegjinë dhe Spanjën tregon se SHBA mbetet e përkushtuar për sigurinë në kontinent. "Ne shohim një angazhim të fortë të Shteteve të Bashkuara për sigurinë evropiane dhe kjo është diçka që ne e vlerësojmë", tha ai.

Z. Geoană ishte në panelin "Ripërcaktimi i Sigurisë Transatlantike Gjithëpërfshirëse në epokën COVID" me ish Sekretaren e Shtetit të SHBA Madeleine Albright.

Konferenca vjetore Transatlantike u organizua nga Projekti i Shkollës së Harvard Kennedy për Evropën dhe marrëdhëniet Transatlantike, dhe nga partneri i tij Akademik Spanjoll, Shkolla IE e Çështjeve Globale dhe Publike, në bashkëpunim me Fundación Rafael del Pino.



## NATO bashkëpunon me Kryqin e Kuq Ndërkombëtar

*Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s takohet me Kryetarin e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq në Selinë e NATO-s*

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Mircea Geoana u takua me Presidentin e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK) Ambasadori Peter Maurer në Selinë e NATO-s më 8 korrik 2020, për një shkëmbim mendimesh mbi ndikimin e pandemisë COVID-19 dhe mbi aktivitetet e të dy organizatave. Z. Geoana vuri në dukje se gjatë krizës COVID-19 ka pasur kontakte të rregullta midis NATO-s dhe ICRC në nivele të shumëfishta.

Ai tha se aleatët e NATO-s po përgatiten për një valë të mundshme të dytë të COVID-19 dhe theksoi se në qershor ministrat e Mbrojtjes të NATO-s miratuan një Plan Operacioni për të ndihmuar, nëse është e nevojshme, aleatët dhe partnerët në shpërndarjen e artikujve dhe pajisjeve kritike. Ai tha se ministrat e Mbrojtjes të NATO-s gjithashtu ranë dakord të krijojnë një rezervë të artikujve mjekësorë dhe një fond besimi të përgjigjes pandemike për t'iu dhënë mundësi aleatëve të NATO-s të fitojnë furnizime dhe shërbime mjekësore.

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm theksoi gjithashtu se NATO vlerëson mbështetjen e ICRC për zbatimin e politikës së NATO-s për mbrojtjen e civilëve dhe se kjo është një temë thelbësore për operacionet dhe misionet e NATO-s.

NATO njoftoi më 4 korrik se trupat e saj jo-luftarake në Afganistan realizuan operacionin më të madh të furnizimit me pajisje mjekësore, për të ndihmuar forcat afgane të sigurisë që të luftojnë koronavirusin.

Njoftimi nga misioni "Mbështetja e Vendosur", me trupa nga 38 vende erdhi vetëm disa ditë pas njoftimeve se pandemia e koronavirusit ka goditur forcat afgane të sigurisë, duke minuar aftësinë e tyre për t'iu kundërvënë sulmeve në rritje nga kryengritësit talibanë.

"Më shumë se 1.4 milionë maska, 500,000 doreza, 460,000 veshje mjekësore dhe pajisje kirurgjikale janë duke u shpërndarë për ushtrinë dhe policinë në mbarë Afganistanin", thuhet në një postim në Twitter të NATO-s.

Në mesazhin e postuar në Twitter përsëritet angazhimi i NATO-s për të mbështetur forcat afgane të sigurisë në përpjekjet e tyre për të siguruar paqen në vend.

Një artikull i publikuar kohët e fundit në gazetën The Washington Post citoi zyrtarë afganë të sigurisë (të cilët folën me kusht që të mbeteshin anonim) në katër provinca të kenë thënë se dyshohet për infeksione në nivel 60 deri 90 për qind në mesin e personelit të forcave të sigurisë. Përhapja e madhe e koronavirusit njoftohet se ka zvogëluar numrin e forcave afgane në dispozicion për të kryer operacionet kundër Talibanëve dhe detyra të tjera jetësore, përfshirë pikat e sigurisë në bazat ushtarake.

Ministria afgane e Mbrojtjes hodhi

## NATO ndihmon ushtrinë afgane kundër përhapjes së "Covid-19"



poshtë raportet për infeksione në shkallë të gjerë në mesin e forcave të sigurisë, duke thënë se janë marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar përhapjen e virusit në bazat ushtarake.

Ndërsa në datën 4 korrik, Ministria afgane e Shëndetësisë tha se numri i rasteve të konfirmuara me Covid-19 në Afganistan, një vend me 37 milionë banorë, është rritur në gati 33,000, ndërsa 826 njerëz kanë vdekur nga koronavirusi. Zyrtarët e shëndetësisë

kanë paralajmëruar se numri real i të prekurve me Covid-19 është shumë më i lartë për shkak të aftësive të kufizuara të testimit mes sfidave të tjera me të cilat përballet sistemi i kujdesit shëndetësor i goditur nga lufta, dhe se deri në 26 milionë njerëz në vend mund të infektohen në muajt e ardhshëm. Ka gjithashtu njoftime se koronavirusi po përhapet edhe në mesin e komandantëve dhe luftëtarëve Talibanë, megjithëse zyrtarët e grupit

kryengritës i kanë mohuar ato.

Autoritetet afgane thonë se ka patur një rritje të sulmeve nga kryengritësit Talibanë në javët e fundit, në të cilat janë vrarë dhe plagosur qindra anëtarë të forcave të sigurisë. Në luftime janë vrarë edhe civilë.

Dhuna vjen ndërsa palët rivale në Afganistan përgatiten të zhvillojnë bisedime të paqes që kanë për qëllim arritjen e një armëpushimi dhe një marrëveshjeje për ndarjen e pushtetit.

Dialogu është parashikuar në një pakt të rëndësishëm që Shtetet e Bashkuara e nënshkruan me Talibanët në shkurt për t'iu dhënë fund gati dy dekadave të armiqësisë në Afganistan. Fillimi i bisedimeve të paqes mes fraksioneve brenda Afganistanit, megjithatë, është i lidhur me përfundimin e një shkëmbimi të vazhdueshëm të të burgosurve midis qeverisë afgane dhe talibanëve.

Kabuli duhet të lirojë rreth 1.000 të burgosur të tjerë talibanë nga 5,000 që parashikon marrëveshja. Kryengritësit kanë liruar rreth 740 anëtarë forcave afgane nga 1.000 që ata kishin premtuar se do t'iu lironin.

Në bazë të marrëveshjes mes Shteteve të Bashkuara dhe Talibanëve, të gjitha trupat amerikane dhe ato të aleatëve do të largohen nga Afganistani deri në korrik të vitit 2021, nëse jepen garanci që grupi kryengritës do të parandalojë terroristët transnacionalë të përdorin vendin për sulme ndërkombëtare, dhe angazhohen në një proces pajtimi politik për t'iu dhënë fund dhunës. Ndërkohë, përfaqësuesi i lartë civil i NATO-s në Afganistan, Stefano Pontecorvo, ka paralajmëruar se dhuna e talibanëve po pengon përpjekjet për të filluar bisedimet ndër-afgane të paqes.

Pontecorvo e publikoi deklaratën në një postim në Twitter pasi informoi vendet anëtare të NATO-s në Bruksel për zhvillimet e fundit në Afganistan. "Ne diskutuam gjithashtu situatën në terren, dhuna nga Talibanët duhet të zvogëlohet, ajo është thjesht e papranueshme dhe po krijon probleme në përpjekjet për të rifilluar bisedimet e paqes", tha ai.





Objektiv shumë i rëndësishëm për vendin tonë dhe për dy ministrinë tona është edhe angazhimi dhe aktivitetet për integrim në NATO, për çka kërkohet bashkëpunim dhe koordinim për një qasje më efektive. Po ashtu, gjatë takimit mes dy ministrave u bisedua edhe për angazhimin e FSK-së, në misione paqësore jashtë vendit, ku kërkohet bashkëpunimi dhe koordinimi edhe me Ministrinë e Jashtme, që kushtëzohet përmes nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit dypalësh me shtetet përkatëse.



ANTON QUNI-MELIZA HARADINAJ:

**M**inistri i Mbrojtjes Anton Quni, priti në takim ministrën e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, znj. Meliza Haradinaj, me bashkëpunëtorë. Në pritje, ishin të pranishëm edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant Rrahman Rama, sekretari i përgjithshëm Faruk Geci dhe shefi i Kabinetit të Ministrit Jashar Ramadani. Ministri Quni, me këtë rast e njoftoi ministrën Haradinaj, me zhvillimet e deritashme të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë të Kosovës, si dhe me objektivat për të ardhmen. Ministri Quni, vlerësoi se, si vend jemi në rrethana të reja dhe na imponohen edhe aktivitetet të reja, të cilat kërkojnë një koordinim dhe bashkëpunim në mes dy ministrave tona, për të arritur objektivat me interes shtetëror.

Objektiv shumë i rëndësishëm për vendin tonë dhe për dy ministrinë tona është edhe angazhimi dhe aktivitetet për integrim në NATO, për çka kërkohet bashkëpunim dhe koordinim për një qasje më efektive. Po ashtu, gjatë takimit mes dy ministrave u bisedua edhe për angazhimin e FSK-së, në misione paqësore jashtë vendit, ku kërkohet bashkëpunimi dhe koordinimi edhe me Ministrinë e Jashtme, që kushtëzohet përmes nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit dypalësh me shtetet përkatëse. Gjatë takimit u theksua se ka hapësirë për punë të përbashkëta, për të shprehur interesimin, për të qenë jo vetëm prezent por edhe për anëtarësim në organizatat dhe nismat regjionale të sigurisë. Çështje me rëndësi gjatë takimit ishte edhe diskutimi rreth harmonizimit të statusit të atashëve ushtarakë të FSK-

# Të rrisim përfaqësimin e Kosovës në NATO, në nivel të ambasadorëve

*Angazhimi i FSK-së, në misione paqësore jashtë vendit, kërkon bashkëpunimin përmes nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit dypalësh, me shtetet përkatëse*



së në ambasadat e Kosovës.

Nga ana e saj ministrja Haradinaj, u shpreh se prioriteti i lartë i Ministrisë së Punëve të Jashtme është integrimi në NATO, dhe për këtë ne duhet të koordinojmë veprimet tona, duke shtuar se në këtë drejtim jemi të interesuar të rrisim

përfaqësimin e Kosovës në NATO, në nivel të ambasadorëve. Për çështjet e shtruara, ne jemi të hapur për çdo bashkëpunim dhe sidomos për angazhimin e FSK-së, në misione paqësore jashtë vendit për çka kërkohet një punë e vazhdueshme koordinuese.

Qendra e Ekselencës për Udhëheqje, për nënoficerë në SHBA:

## Dy nënoficerë përfunduan kursin e rreshter majorëve në SHBA

**R**adhëve të rreshter majorëve të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), të cilët kryen kursin e rreshter majorëve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA), më 19 qershor 2020, iu shtuan edhe Rreshter Majori i Komandës Bedri Zuka dhe Rreshter Master Rifadije Ramadani, të cilët përfunduan me sukses Kursin e Rreshter Majorëve në Qendrën e Ekselencës për Udhëheqje për nënoficerë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përkatësisht në Bazën Fort Bliss në El Paso në Teksas.

Ky institucion më herët ka qenë i njohur si Akademia e Rreshter Majorëve. Kursi i Rreshter Majorëve është program 12 mujor, që përgatit Rreshter-Major, për principet e lidhshme, për udhëheqjen e trupës së nënoficerëve, për këshillimin e nivelit të lartë të oficerëve lidhur me funksionimin e trupës së nënoficerëve, për ekzekutimin e operacioneve të përbashkëta tokësore, duke përfshirë të gjitha degët e ushtrisë Amerikane

## Me rëndësi është integrimi i komuniteteve në MM dhe në Forcën e Sigurisë

Prezantohet Sadika Kofrc, zëvendësministre e Ministrisë së Mbrojtjes, përfaqësuese e komunitetit boshnjak

**M**inistri i Mbrojtjes Anton Quni, priti në ditën e parë të punës, zëvendësministren e Mbrojtjes nga radhët e komuniteteve jo shumicë, znj. Sadika Kofrc, pas marrjes së detyrës me vendimin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Abdullah Hoti. Zëvendësministria Kofrc shoqërohej edhe nga deputetja e Parlamentit të Kosovës, Duda Bale nga radhët e komunitetit boshnjak. Në pritje ishin të pranishëm edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant Rrahman Rama, sekretari i përgjithshëm Faruk Geci dhe shefi i Kabinetit të Ministrit Jashar Ramadani.

Ministri Quni, me këtë rast i dëshiroi mirëseardhje zëvendësministres Kofrc, të cilën e njoftoi mbi procesin e deritashëm të zhvillimit të



Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, si dhe me objektivat e përgjithshme për të ardhmen. Ministri Quni, gjithashtu e njoftoi ministrën Kofrc, edhe me integrimin e pjesëtarëve nga radhët e komuniteteve jo shumicë në Forcën e Sigurisë të Kosovës. Ai e cilësoi si shumë të rëndësishëm emërimin e zëvendësministrit të ri të Mbrojtjes, nga radhët e komunitetit boshnjak, dhe të cilën e përgëzoi dhe njëherësh i


premtoi bashkëpunim në realizimin e detyrave të përgjithshme. Nga ana e saj, zëvendësministria Sadika Kofrc, falenderoi ministrin Quni për pritjen dhe gatishmërinë për ta përkrahur gjatë kryerjes së detyrave si zv. ministre e Ministrisë së Mbrojtjes. Ajo u zotua se do të angazhohet me të gjitha kapacitetet e saja në përmbushjen e të gjitha objektivave të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së.



si dhe operacionet ndërkombëtare në bashkëpunim me agjenci të ndryshme. Shkollimi i oficerëve të FSK-së, është mbështetur nga Zyra për Mbrojtje dhe Bashkëpunim pranë Ambasadës së SHBA-ve, në Kosovë. Rreshter Majori i Komandës Bedri Zuka dhe Rreshter Master Rifadije Ramadani gjatë shkollimit në Qendrën e Ekselencës për Udhëheqje për Nënoficerë në SHBA, treguan disiplinë, angazhim dhe profesionalizëm, si dhe e përfunduan me sukses të lartë Kursin e Rreshter Majorëve, klasa 70.

Diplomimi i dy rreshter majorëve në përgjithësi është një e arritur e radhës për FSK-në, ku deri më tani në këtë Akademi të rreshter majorëve, kanë diplomuar me sukses të dalluar gjithsej shtatë oficerë të FSK-së.





“Pagat në Armatë praktikisht shënojnë rritje çdo vit. Së pari 10 përqind, pastaj 5 përqind, pastaj një rritje për civilët, një 10 përqind shtesë dhe këtë vit kompensimi për qira. Nëse në vitin 2017 një ushtar profesionist sillte në shtëpi 20,000 denarë, sot me rritjen dhe kompensimin, ai sjell në shtëpi më shumë se 31,000 denarë. Kjo është një rritje prej 60 përqind,”-tha ministrja. Shekerinska-shtoi se pagat e civilëve në Armatë, me rritjen e pagës dhe shtesën për kompensim qiraje janë rritur me rreth 70 përqind.



MINISTRJA SHEKERINSKA NË KAMPIN PËR TRAJNIME NË UJË-OHËR

# Gjatë tre viteve buxheti dhe rrogat për armatën janë rritur

*Ndërsa buxhetet dhe të ardhurat rriten, edhe interesi për të qenë pjesë e Armatës rritet*

**A**nëtarësimi në NATO dhe buxhetet e rritura çdo vit na japin një shans të investojmë shumë më tepër në të gjitha njësitë dhe në pjesë të ndryshme specifike të Armatës sonë. Kemi treguar për tre vjet rresht që buxhetet e mbrojtjes mund të rriten, që do të thotë se mund të sigurojmë kushte më të mira, metoda më të mira pune, -tha ministrja e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska, gjatë një vizite tek pjesëtarët e Armatës në Kampin për Trajnime në Ujë të Ohrit.

Shekerinska, -tha se gjatë viteve të kaluara, përqendrimi kryesor ka qenë në gjërat e përditshme, që do të nënkuptojnë jetë – pra, mbi pagat dhe kushtet.

“Pagat në Armatë praktikisht shënojnë rritje çdo vit. Së pari 10 përqind, pastaj 5 përqind, pastaj një rritje për civilët, një 10 përqind shtesë dhe këtë vit kompensimi për qira. Nëse në vitin 2017 një ushtar profesionist sillte në shtëpi 20,000 denarë, sot me rritjen dhe kompensimin, ai sjell në shtëpi më shumë se 31,000 denarë. Kjo është një rritje prej 60 përqind,”-tha ministrja.



Shekerinska-shtoi se pagat e civilëve në Armatë, me rritjen e pagës dhe shtesën për kompensim qiraje janë rritur me rreth 70 përqind.

Ndërsa buxhetet dhe të ardhurat rriten, edhe interesi për të qenë

pjesë e Armatës rritet. Ministrja informoi se në konkursin e fundit për ushtarë profesionistë për 70 vende,

janë paraqitur mbi 700 kandidatë, gjë që mundëson zgjedhjen e më të mirëve dhe më cilësorëve.

Në Kampin për Trajnime në Ujë, ministrja iu referua edhe blerjes së pajisjeve themelore për pjesëtarët e Armatës, uniformat dhe çizmet, për të cilat,-tha ajo, qëllimi është të realizohet prokurimi i rregullt dhe rinovimi i kësaj pajisje themelore. Ajo shtoi se tre ndërtesa aktualisht janë duke u rikonstruktuar, dhe se rikonstrukcione të tilla do të vazhdojnë, duke pasur parasysh që Armata zotëron ndërtesa të vjetra nga 50 deri në 60 vjet. Shekerinska falenderoi pjesëtarët e Armatës për pjesëmarrjen në aktivitetet lidhur me gjendjen e jashtëzakonshme dhe u tha atyre se si ushtarë dhe oficerë të NATO-s, prej tyre pritet shumë, por ata me të drejtë do të marrin më shumë dhe më mirë.

## Ushtarët kujtojnë traditat historike

**A**nëtarët e Batalionit të 4-të të Këmbëorisë (Divizionit të 4 të Këmbëorisë) nga Brigada e Parë e Këmbëorisë (Brigada e 1 e Këmbëorisë) përkujtuan ditën e vdekjes së heroit kombëtar Chede Filipovski-Dame, emri i të cilit mban kazerma në Kërçovë, duke iu përmbajtur të gjitha masave dhe rekomandimeve për trajtimin e pandemive.

Në ceremoni morën pjesë Komandanti i Divizionit të Parë të Këmbëorisë, kolonel Besnik Emini, me një pjesë të selisë dhe Komandantët e njësisë vartëse të Divizionit të Parë të Këmbëorisë.

Komandanti i Divizionit të 4-të të Këmbëorisë, nënkolonel Goran Trajanoski, në fjalimin e tij me rastin e shënimit të patronazhit të



kazermave, foli për rrugën e jetës dhe punën e heroit kombëtar Chede Filipovski-Dame.

Si pjesë e ceremonisë përkujtimore ishin edhe përfaqësues

nga struktura të tjera ushtarake të Armatës ushtarake maqedonase, të cilët vendosën lule të freskëta përpara bustit të heroit kombëtar Chede Filipovski-Dame.




## Në kazemat ushtarake realizohet aksioni për dhurimin e gjakut

**N**ë kazemat “Aleksa Demnievski Bauman” dhe “Aleksa Demnievski Bauman” u realizua një aksion për dhurim vullnetar të gjakut, ku morën pjesë 25 ushtarakë. Kjo ishte pjesë e planit dhe programit të këtij viti për Kryqin e Kuq, duke pasur parasysh aktivitetet e vonuara të grupit, për shkak të rrethanave të trajtimit të pandemisë COVID-19.

Me këtë veprim, anëtarët e Ushtrisë treguan edhe njëherë humanizmin e tyre në veprim, ku në gjendje të jashtëzakonshme, me shumë kujdes dhe respekt për masat mbrojtëse të përcaktuara nga qeveria, dhe gjithashtu në një kohë kur ata janë të angazhuar në shumë detyra të tjera që lidhen me trajtimin e virusit, COVID-19.

Ekipet nga Instituti i Mjekësisë së Transfuzionit në Shkup dhe Kryqi i Kuq shprehën falënderimet e tyre për anëtarët e Ushtrisë dhe nuk e fshehën kënaqësinë e tyre për njësitë e dhuruara të gjakut në situatën aktuale emergjente, kur është e vështirë të kryhet dhurimi normal i gjakut.





I Dërguari i Mbrojtjes i Republikës së Turqisë, kolonel Sakir Cumhur Somer, shprehu kënaqësi për bashkëpunimin midis dy vendeve në fushën e mbrojtjes dhe theksoi se ai do të vazhdojë të avokojë për përmirësimin e mëtejshëm të tij në të ardhmen, përmes zbatimit të suksesshëm të aktiviteteve me interes të ndërsjelltë.



## MALI I ZI-REPUBLIKA E TURQISË

# Firmoset plani i bashkëpunimit ushtarak dypalësh për vitin 2020

*Janë përcaktuar projekte të reja dypalëshe dhe shumëpalëshe, me fokus trajnimin dhe edukimin ushtarak, për modernizimin e ushtrisë së Malit të Zi*

**K**reu i Drejtorisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Diplomaci të Mbrojtjes, Zana Spadijer, dhe i Dërguari i Mbrojtjes i Republikës së Turqisë, kolonel Sakir Cumhur Somer, nënshkruan Planin e bashkëpunimit dypalësh midis Malit të Zi dhe Republikës së Turqisë në Fushën e Mbrojtjes për vitin 2020.

Takimi midis Shefit Spadijer dhe Kolonel Somer ishte një mundësi për të rishikuar bashkëpunimin aktual të mbrojtjes midis Malit të Zi dhe Turqisë, siç dëshmohej nga zbatimi i suksesshëm i aktiviteteve të shumta bilaterale. Kryetari Spadijer shprehu kënaqësi për takimin dhe falënderoi për mbështetjen e gjithanshme, që Turqia i dha vendit tonë në fushën e mbrojtjes, me besimin se bashkëpunimi dypalësh midis dy vendeve do të përmirësohet më tej në periudhën e ardhshme.

Spadijer gjithashtu theksoi rolin e rëndësishëm që Ushtria e Malit të Zi, ka luajtur në luftën kundër pandemisë COVID-19, dhe falënderoi për dhurimin nga Turqia drejt Malit të Zi, të ndihmave mjekësore në prill të këtij viti, duke theksuar se kjo përfaqëson një shprehje solidariteti midis dy vendeve.

I Dërguari i Mbrojtjes i Republikës së Turqisë, kolonel Sakir Cumhur Somer, shprehu kënaqësi për bashkëpunimin midis dy vendeve në fushën e mbrojtjes dhe theksoi se ai do të vazhdojë të avokojë për përmirësimin e mëtejshëm të tij në të ardhmen, përmes zbatimit të suksesshëm të aktiviteteve me interes të ndërsjelltë.

Shefi Spadijer, informoi Kolonel Somerin për pjesëmarrjen e tanishme të anëtarëve të Ushtrisë Malazeze,



në misionet ndërkombëtare, si dhe angazhimin për modernizimin e kapaciteteve të Ushtrisë së Malit të Zi dhe pajisjeve të tij në përputhje me standardet e Aleancës. Bashkëbiseduesit ranë dakord se nënshkrimi i Planit të bashkëpunimit dypalësh në fushën e mbrojtjes midis dy ministrive ka

një rëndësi të madhe për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të mbrojtjes, dhe theksuan gatishmërinë për të përcaktuar projekte të reja dypalëshe dhe shumëpalëshe të rëndësishme, me fokus trajnimin dhe edukimin ushtarak, brenda modernizimit të Ushtrisë së Malit të Zi.

KAPITENE JOVICA MIJUŠKOVIĆ:

## “Nuk mbështes aktivitete që s’janë të përshtatshme për ushtarakët”

“Unë, Jovica Mijušković, me origjinë nga fshati Povija në komunën e Nikçiqit, si kapiten në Ushtrinë e Malit të Zi, mohoj publikisht që jam nënshkruar i letërës së botuar në Srpske novine, e cila i referohet mbështetjes time të pretenduar për Kishën Ortodokse Serbe. Unë nuk e di se si u formua lista, si dhe si ishte emri im në të, por unë mësova për përmbajtjen e saj përmes mediave. Ajo që di me siguri dhe e theksoj në këtë mënyrë, është se nuk e mbështes Kishën Ortodokse Serbe, ose ndonjë organizatë fetare në një mënyrë të tillë. Unë besoj thellësisht se përkatësia fetare e secilit individ është çështja e tij intime. Jam krenar që theksoj se jam anëtar i Ushtrisë së Malit të Zi, një vend që e dua dhe kam shërbyer për gati 15 vjet. Gjithashtu, përveç detyrës sime të rregullt si oficer i Ushtrisë së Malit të Zi, unë gjithashtu kryej detyrën e një prokurori disiplinor ushtarak, dhe për këtë arsye unë kurrë nuk do të mbështesja asnjë lloj aktiviteti që nuk është i përshtatshëm për personelin ushtarak profesional. Vlerësoj, që një listë e tillë duhet të përmbajë të dhëna të sakta, domethënë përveç emrit dhe mbiemrit, datën e lindjes ose emrin e prindit. Përndryshe, ka shumë hapësirë për keqpërdorim të të dhënave personale, dhe publikut i mbetet i mohuar konfirmimi i nënshkruesit. Nga atje, ku janë rrënjët e mia, me sa di unë, nuk ka asnjë person tjetër me të njëjtin emër dhe mbiemër, dhe në këtë rast të veçantë unë arsyeshëm supozoj se të dhënat e mia personale janë keqpërdorur në një mënyrë që, pavarësisht nga qëllimi që padyshim kërkohet të arrihet, nuk mund të justifikoni mjetet”.

Ministri Bozković në Kampin Ushtarak Veror:

## “Kampin Ushtarak Veror do ta ndërkombehtarizojmë”

-tha që ishte i nderuar të marrë pjesë në Kampin Ushtarak Veror, si dhe planifikoi të aplikonte për një akademi ushtarake. “Kampi plotësoi plotësisht pritjet e mia, sidomos mbijetesë e sotme tregon se sa jemi të gjithë, dhe nëse disa nuk mendojnë se mund, si një ekip ne arritëm të bënim shumë”.

Teodora Fatić nga Berane, -tha se ajo aplikoi për Kampin Ushtarak Veror sepse e do vendin e saj dhe sepse në këtë periudhë të jetës së saj, ajo ka mundësinë të veshë një uniformë me shenjat e ushtrisë dhe vendit të saj. “Asgjë nuk është e vështirë për mua në kamp, unë jam e kënaqur me komandantët e mi, si dhe me të gjithë organizatën. Më pëlqen veçanërisht kompania, në këtë trajnim ishte ushqyerja dhe mbijetesë, ato që më bënë të kuptoj atë se çfarë po na thoshin pleqtë tanë, sa e rëndësishme është të lidhemi me natyrën, të jemi pjesë e saj, si dhe një pjesë e jetës në kolektiv. Kur punojmë si ekip, asgjë nuk është e vështirë për ne, e kuptojmë se gjithçka mund të zgjidhet

nëse bashkojmë forcat”.

Kampi i Pestë Ushtarak Veror për Rininë, mbledhi 65 nxënës të shkollave të mesme, të cilët kanë mundësinë të provojnë dorën e tyre në shërbimin ushtarak, në njësitë ushtarake në Kolašin, Pljevlja dhe Tivar. Gjatë kampit, nxënësit e shkollave të mesme do të provojnë dorën e tyre në topografi dhe orientim, trajnime mjekësore dhe alpinizëm, kampe, ushqyerje dhe mbijetesë në natyrë, si dhe aktivitete të tjera.

Kampi ushtarak veror, mbahet në përputhje me masat dhe rekomandimet e përcaktuara të Organit Kombëtar Koordinues për sëmundjet infektive, si dhe Institutit të Shëndetit Publik.

Pjesëmarrësit në kamp u vizituan gjithashtu nga Kryetari i Komunës së Mojkovacit, Ranko Mišnić, dhe Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë për Arsimit të Mesëm të Përgjithshëm, Arsimit të Mesëm Profesional dhe të Rritur të Ministrisë së Arsimit, Veljko Tomić.


**M**inistri i Mbrojtjes, Predrag Boshković, së bashku me Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, gjeneralmajor Dragutin Dakić, vizituan Kampin Ushtarak Veror për Rininë, ku po zhvillohen aktivitete ushqyese dhe mbijetesë në natyrë.

Ministri Bošković, shprehu kënaqësinë e tij për vizitën në Kampin Ushtarak Veror, ku 65 të rinj njihen për herë të parë me profesionin ushtarak. “Ajo që është e rëndësishme është se veprimtaria e Kampit Ushtarak Veror, nuk është vetëm edukimi i tyre kur bëhet fjalë për shërbimin ushtarak ose kur bëhet fjalë për të qëndruar në natyrë, por mbi të gjitha shoqërimin e tyre. Shoqërimin e të rinjve nga i gjithë Mali i Zi, por edhe një trajnim i shkëlqyeshëm ku patriotizmi ndaj vendit të tyre është nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, miqësia që ata vendosin këtu me siguri do të zgjasë një jetë”, -tha Ministri Bozković.

Ministri gjithashtu njoftoi planet e mëtejshme ku bëhet fjalë për Kampin Ushtarak Veror. “Plani ynë nuk është vetëm të rrisim Kampin Ushtarak Veror kur bëhet fjalë për numrin e pjesëmarrësve, por edhe ta ndërkombehtarizojmë atë sa më shumë që të jetë e mundur. Nga viti tjetër, shpresoj se do të kemi nxënës të shkollave të mesme nga SH.B.A., Maqedonia, Sllovenia dhe disa vende të tjera këtu”, -tha Ministri.

Studenti i kampit Dalibor Španjević, nga Nikshiq





“Jam i bindur që me aftësitë që fitoni, nën udhëheqjen e Komandantëve tuaj, ju do të justifikoni moton tuaj -”Aty ku të tjerët nuk mundën”. Mos harroni se në Muzeun Ushtarak Bullgar ka dhjetëra flamuj të huaj, të betejave me kundërshtarët tanë të mposhtur, por askund në botë nuk ka një flamur të kapur bullgar në beteja. Ju uroj që flamujt t’i mbani të pastër e të paqtë dhe ta drejtoni flamurin në pozicionet e kundërshtarit të mposhtur, por kurrë të mos bieni në duar të gabuara”.



MINISTRI I MBROJTJES KRASSIMIR KARAKACHANOV:

## “Zhvillimi i Forcave Speciale do të vazhdojë”

“Sot nderojmë guximin e të gjithë ushtarëve të garnizonit të Plovdivit, që ranë në fushat e betejave të Luftërave Ballkanike, Luftes së Parë dhe të Dytë Botërore për të realizuar idealin kombëtar bullgar - bashkimin e të gjithë bullgarëve nën një çati. Në këtë festë ne kujtojmë të gjithë luftëtarët bullgarë që në kohë paqeje përgatiteshin dhe shërbyen për të mbrojtur integritetin territorial dhe sovranitetin e Bullgarisë”. Këtë tha Ministri i Mbrojtjes Krassimir Karakachanov, më 4 korrik, në Plovdiv, ku u mbajt një ritual për shenjtërimin dhe prezantimin e betejës dhe flamurit përfaqësues të Komandës së Përbashkët të Operacioneve Speciale (JCC). Në ceremoni morën pjesë gjithashtu edhe Kryeministri Boyko Borissov.

Dorëzimi i flamujve të Komandës së Përbashkët të Operacioneve Speciale është një veprim që kalon në fazën tjetër të zhvillimit të Forcave Speciale Bullgare. Do të vazhdojë me krijimin e një grupi tjetër të forcave speciale në Sofje, -shtoi Ministri Karakachanov. “Jam i bindur që me aftësitë që fitoni, nën udhëheqjen e Komandantëve tuaj, ju do të justifikoni moton tuaj -”Aty ku të tjerët nuk mundën”. Mos harroni se në Muzeun Ushtarak Bullgar ka dhjetëra flamuj të huaj, të betejave me kundërshtarët tanë të mposhtur, por askund në botë nuk ka një flamur të kapur bullgar në beteja. Ju uroj që flamujt t’i mbani të pastër e të paqtë dhe ta drejtoni flamurin në pozicionet e kundërshtarit të mposhtur, por kurrë të mos bieni në duar të gabuara”.

Kryeministri Boyko Borissov ka uruar ushtarakët nga SHSSH, për marrjen e flamurit të tyre të ri të betejës dhe u uroi atyre shëndet dhe sukses në shërbim. “Në konfliktet rajonale, ose, Zoti na ruajt, këta janë njerëzit në të cilët mbështetemi më shumë,” -tha ai. Si Shef i Mbrojtjes, unë qëndroj prapa Komandës së Përbashkët të Operacioneve Speciale. Unë qëndroj prapa fjalës “së bashku”. Këtë e theksoi Shefi i Mbrojtjes Admirali Emil Eftimov, në fjalimin e tij përshëndetës me rastin e dorëzimit të flamurit të betejës dhe hapjes së Komandës së Përbashkët të Operacioneve Speciale (JCC). Ai ishte i bindur se vërtetimi i Grupit Taktik të Operacioneve Speciale (TGRSO) për t’u antarësuar në Forcën e Reagimit të NATO-s, ishte i suksesshëm, dinamik dhe kompleks, falë përpjekjeve të përbashkëta të bëra.

Admirali Eftimov, falënderoi udhëheqjen shtetërore dhe politike të Ministrisë së Mbrojtjes, për përshpejtimin e krijimit të JCC në Rishikimin Strategjik të Mbrojtjes.

Admirali Eftimov iu drejtua Komandantit të Forcave Speciale, gjeneralmajor Yavor Mateev: “Z.



Gjeneral, ju tashmë keni uniformat e tjera të Forcave të Armatosura, le të shumëzohet ky numër! Prapa jush keni komandantët e Forcave të Armatosura dhe të gjithë Komandantët e formacioneve të Ushtrisë Bullgare. Punoni për komunitetin, kjo është e nevojshme në kushte moderne! “, -tha Shefi i Mbrojtjes.

Si përgjigje, gjeneralmajori Yavor

Mateev, theksoi se sot është një ditë e paharrueshme për Forcat e Operacioneve Speciale të Ushtrisë Bullgare. “Forcat speciale të ushtrisë bullgare kaluan nëpër maja, por edhe shumë prova,” - tha ai. “Edhe sot ne bëjmë më të mirën me atë që kemi për të kryer detyrat tona, në interes të sigurisë kombëtare dhe sovranitetit të Republikës së Bullgarisë,” -tha gjeneralmajor Yavor Mateev.

“Gjithçka që kemi arritur është falë punës sonë të përbashkët. Vetëm me besim dhe punë të palodhur burrat dhe gratë e Forcave Speciale arritën atë që jemi sot: ata fituan vendin e tyre në hierarkinë e Ushtrisë Bullgare dhe vendin e tyre të veçantë në arkitekturën e sigurisë kombëtare. Republika e Bullgarisë,” - tha Gjeneralmajor Mateev.

Rituali i shenjtërimin të flamujve u krye nga Shenjtëria e Tij Metropolitan Nikolaj i Plovdivit, në bashkëpunim me priftërinjtë nga Dioqeza e Plovdivit. Në prezantimin e flamujve mori pjesë edhe Kryetari i Komitetit të Mbrojtjes në Asamblenë Kombëtare, O.Z. Gjeneral Konstantin Popov, Komandantë të formacioneve ushtarake, deputetë, përfaqësues të pushtetit vendor dhe qendror në Plovdiv, veteranë. Midis të ftuarve të huaj, ishin Komandanti i Forcave Speciale të Sh.B.A në Evropë, gjeneralmajor Kirk Smith, si dhe komandantët e forcave speciale në Greqi dhe Rumani. Majori George Tsiotokostas dhe gjeneral Brigade Dacian Sherban.

Komandanti i SHSSH-së, gjeneralmajor Yavor Mateev, i paraqiti një pllakë Komandës së Kryeministrit, Ministrit të Mbrojtjes, Shefit të Mbrojtjes, Kryetarit të Komitetit të Mbrojtjes së Asamblesë së 44-të Kombëtare dhe Znj. Valentina Botseva, gruas së ish-Shefit të Mbrojtjes së Përgjithshme Andrey Botsev.

STËRVITJA “STEALTH DAGGER 2020”

## Admirali Eftimov: “Duhet të jemi krenarë për Forcat tona Special”

*Komisioni i SCSO, çertifikoi Grupin Taktik të Operacioneve Speciale (TGRSO) për t’u bashkuar me Forcën e Reagimit të NATO-s, në vitin 2021*

“Në pamë një demonstrim shumë mbresëlënës. Ne duhet të jemi krenarë për Forcat tona Speciale, me përgjegjësinë e tyre, aspiratën dhe gatishmërinë për të zotëruar detyra të reja. Ky është një proces i gjatë dhe dua të vërej përpjekjet e Komandës së Përbashkët të Operacioneve Speciale (JCC) për Forcat tona Speciale, për të gjetur një vend të denjë në strukturën organizative të Ushtrisë Bullgare “, -tha më 3 korrik, Shefi i Mbrojtjes Admirali Emil Eftimov, i cili ishte i pranishëm në fazën e fundit të stërvitjes kombëtare “Stealth Dagger 2020” në Aeroportin Cheshnegirovo. Stërvitja “Stealth Dagger 2020”, u mbajt nga 20 qershor deri më 3 korrik, me pjesëmarrjen e deri 150 ushtarakëve nga SHKSS, Forca Ajrore (Forca Ajrore) dhe Marina (Marina). Gjatë stërvitjes, një komision i SCSO çertifikoi Grupin Taktik të Operacioneve Speciale (TGRSO,) për t’u

bashkuar me Forcën e Reagimit të NATO-s në 2021.


“Çertifikimi i TGRSO, për avokim në detyrë ndaj Forcës së Reagimit të NATO-s, është një veprim shumë i përgjegjshëm dhe unë jam i kënaqur që SCSO mbështet standardin”, -tha Admirali Eftimov. Ai sqaroi se ambiciet nuk lidhen vetëm me çertifikimin e Task-Forcës së Forcave Speciale, por edhe me zhvillimin e ardhshëm të këtyre aftësive.

Shefi i Mbrojtjes, falenderoi partnerët tanë ndërkombëtarë dhe shprehu mirënjohjen e tij për Komandantin e Komandës së Forcave Speciale të SHBA në Evropë, gjeneralmajor Kirk Smith, i cili ishte i pranishëm në këtë ngjarje.

Admirali Eftimov, sqaroi se nga fillimi i vitit 2021, ushtarakët e formacionit të çertifikuar do të jenë në detyrë 45-ditore. “Kjo nuk është vetëm një kërkesë për stafin - të jetë i pranishëm dhe zbulimi i duhur. Kërkesat janë të shumta

në aspektin e pajisjeve, armëve, mjeteve të mirëmbajtura të komunikimit, trajnimit. Jam i bindur që djemtë do të përballen”, - tha shefi i mbrojtjes. Përpara gazetarëve, Komandanti i SCSO, gjeneralmajor Yavor Mateev, theksoi se kjo është një fazë tjetër e përfunduar në përgatitjen e një formacioni të tillë ushtarak. “Jam i kënaqur që gjithçka kaloi në mënyrë të sigurt, të gjithë janë gjallë dhe mirë, dhe qëllimet e stërvitjes janë përbushur. Tani e tutje, ne do të ruajmë nivelin e trajnimit tonë në mënyrë që, nëse është e nevojshme, të kryejmë detyra brenda forcave speciale të NATO-s”, -shtoi ai. “Ne nuk kemi pse të jemi të kënaqur me ato që kemi dhe ato që kemi arritur. Ne gjithmonë duhet të përipiemi të azhurnojmë”, -shtoi gjeneralmajor Yavor Mateev në lidhje me demonstrimin e aftësive, armëve dhe pajisjeve nga Grupi Taktik për Operacione Speciale.





“Tani keni përfunduar programet arsimore dhe do të caktoheni në njësitë ushtarake brenda vendit apo misionet ndërkombëtare, në kuadër të bashkëpunimit ushtarak ndërkombëtar dhe aktiviteteve të mbrojtjes kolektive. Në një vit bota do të jetë edhe më e ngushtë, por edhe më e ndërlikuar, duke e bërë rolin tuaj të ruajtjes së pavarësisë dhe sovranitetit kroat më të kërkuar, por edhe të qetë dhe të admiruar, shpresoj, dhe një rrugë për krijimin e karrierës dhe familjeve tuaja”.



Akademia e Mbrojtjes Kroate, “Dr. Franjo Tuđman”:

## Viti akademik 2019-2020, diplomohen 177 studentë ushtarakë

**A**kademia e Mbrojtjes Kroate “Dr. Franjo Tuđman”, organizoi në kazermet në Zagreb, një ceremoni që shënon përfundimin e vitit akademik 2019-2020. Të diplomuarit përfshinin gjeneratën e 22-të të Shkollës së Luftës “Ban Josip Jelačić” (18 studentë), gjeneratën e 28-të të Shkollës së Komandës dhe Stafit “Blago Zadro” (40 studentë), gjeneratën e 19-të të Shkollës Themelore (98 studentë) dhe gjeneratën e 23-të të Shkollës Themelore (Forca Ajrore), si dhe gjeneratën e 18-të të trainimit të lartë të nënoficerëve (15 pjesëmarrës). Ata u prezantuan me diploma dhe simbole të tjera të diplomimit (gradat, unazat, kamxhikët e oficerëve) dhe pjesëmarrësit më të mirë u prezantuan me çmime dhe vlerësime të veçanta.

Ceremonia u ndoq nga Presidenti i Republikës Zoran Milanović si Komandanti Suprem i Forcave të Armatosura Kroate, nga Sekretari i Shtetit për Mbrojtjen Tomislav Ivić, nga i Dërguari i Kryeministrit, nga i Dërguari i Kryetarit të Parlamentit Kroat Miroslav Tuđman, nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Admiralit të Forcave të Armatosura Kroate, Robert Hranj, nga Sekretari i Shtetit për Mbrojtje Zdravko Jakop, nga Komandanti i Akademisë së Mbrojtjes Kroate, gjeneralmajor Mate Pađen, nga Rektori i Universitetit të Zagrebit Damir Boras, nga z. Komandantët e shërbimeve dhe njësitë të Forcave të Armatosura Kroate, nga përfaqësues të Zyrës Presidentit, Ministrisë së Mbrojtjes, të universiteteve dhe të institucioneve kërkimore dhe nga anëtarët e Trupave Diplomatike Ushtarake.

Presidenti i Republikës Zoran Milanović, uroi për përfundimin e suksesshëm të arsimit:

“Tani keni përfunduar programet arsimore dhe do të caktoheni në njësitë ushtarake brenda vendit apo misionet ndërkombëtare, në kuadër të bashkëpunimit ushtarak ndërkombëtar dhe aktiviteteve të mbrojtjes kolektive. Në një vit bota do të jetë edhe më e ngushtë, por edhe më e ndërlikuar, duke e bërë rolin tuaj të ruajtjes së pavarësisë dhe sovranitetit kroat më të kërkuar, por edhe të qetë dhe të admiruar, shpresoj, dhe një rrugë për krijimin e karrierës dhe familjeve tuaja”, - tha Presidenti Milanović.



Duke uruar të diplomuarit, Sekretari i Shtetit për Mbrojtjen Tomislav Ivić si i dërguar i Kryeministrit prezantoi zhvillimin e ardhshëm të Akademisë së Mbrojtjes Kroate, të përgatitur për miratimin e Ligjit për Themelimin e Universitetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë. “Ne kemi drejtuar gjithashtu përpjekjet tona për përmirësimin dhe ndërtimin e infrastrukturës së re në Akademinë e Mbrojtjes Kroate, siç dëshmohet nga objekti i ri i akomodimit dhe objektet e azhurnuara sportive, dhe ne gjithashtu po ndërtojmë një qendër kongresesh, me mbështetjen e Qeverisë Kroate, për t’i siguruar Universitetit të ardhshëm një kampus modern”, përfundoi sekretari i shtetit Ivić.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Kroate Admirali Robert Hranj deklaroi se profilet e studentëve reflektojnë përqendrimin në mësim dhe se ai vazhdon gjatë gjithë jetës. “Unë po ju lutem që të jeni ambicioz në karrierën tuaj të ardhshme, të vendosni synime të larta dhe të përpiqeni për përsosmëri”, -tha Admirali Hranj, duke shprehur krenarinë e tij për transformimin e ardhshëm të Akademisë së Mbrojtjes Kroate në një institucion modern arsimor dhe kërkimor.

Duke ofruar mirëseardhje për studentët dhe vizitorët, Komandanti i Akademisë së Mbrojtjes Kroate, gjeneralmajor Mate Pađen, theksoi

se viti i kaluar akademik ishte veçanërisht sfidues në funksion të pandemisë COVID-19 dhe tërmetit, i cili detyroi Akademinë të rregullojë procesin e trajnimit brenda një kohe të shkurtër, për t’iu dhënë mundësi studentëve të përfundojnë arsimin e tyre.

Gjithsej 177 studentë përfunduan me sukses trajnimin e tyre në shkollat ushtarake, 155 anëtarë të Forcave të Armatosura Kroate, një student nga Ministria e Brendshme dhe një student nga Ministria e Jashtme dhe e Çështjeve Evropiane, përkatësisht një student nga Shoqata Kroate e Zjarrit dhe 19 studentë të huaj të shkollave të oficerëve dhe nënoficerëve, dhjetë nxënës nga Bosnja dhe Hercegovina, tre nxënës nga Mali i Zi, tre studentë nga Maqedonia e Veriut, dy nxënës nga Sllovenia dhe një student nga Republika e Kosovës.

### Forcat kroate janë pjesë e Grupit të Betejës “EUBG 2020-2”

Në Grupin “EUBG 2020-2”, që drejtohet nga Gjermania marrin pjesë: Kroacia, Austria, Çekia, Holanda, Irlanda, Finlanda, Letonia dhe Suedia

Grupi i Betejës i Bashkimit Evropian (EUBG 2020-2) i drejtuar nga Gjermania, në të cilin marrin pjesë forcat kroate, do të jete në një gjendje gatishmërie gjatë gjashtë mujorit të dytë të këtij viti, duke filluar nga data nga 1 korrik 2020. Përveç Gjermanisë dhe Kroacisë, në Grupin e Betejës (EUBG 2020-2) marrin pjesë edhe Austria, Republika Çeke, Holanda, Irlanda, Finlanda, Letonia dhe Suedia.

Pjesa më e madhe e forcave kroate brenda Grupit të Luftimeve janë anëtarë të kompanisë së motorizuar të këmbësorisë nga Batalioni i Ujrave të Brigadës së Mekanizuar të Gardës dhe togës inxhinierike, detashmentet e logjistikës, ekipi i Policisë Ushtarake dhe oficerët e stafit në komandën e Grupit Combat.

Grupi i Betejës i Bashkimit Evropian (EUBG) është një strukturë ushtarake e Bashkimit Evropian, i gatshëm për veprim të shpejtë.

Procesi përgatitor i gatishmërisë gjashtëmuajore, përfshin përgatitje shumëmuajore, duke përfshirë takime periodike përgatitore të ekspertëve nga Shtetet pjesëmarrëse dhe ushtrime për të siguruar përgatitjen dhe krijimin e formave dhe modeleve të veprimit të përbashkët nga Shtetet pjesëmarrëse.

Republika e Kroacisë, deri tani ka marrë pjesë në pesë grupe beteje të Bashkimit Evropian. Ajo mori pjesë për herë të parë në gjysmën e parë të 2011 në Grupin e Betejës së BE, të udhëhequr nga BE. Pas kësaj, në 2012 dhe 2016, Kroacia mori pjesë në Grupet e Betejës të udhëhequra nga Gjermania, dhe vitin në vitin 2017, ajo mori pjesë në Grupin e Betejës të udhëhequr nga Italia. Pjesëmarrja e fundit ishte në gjysmën e dytë të vitit 2019 në Grupin e Betejës të udhëhequr nga Polonia.



### Helikopterët ushtarakë ndihmojnë turistët gjermanë dhe hungarezë

Ekipet fluturuese të Skuadronit të 395-të të Helikopterëve të Transportit të krahut të 93-të të Forcës Ajrore Kroate (HRZ), nga kazermet “Knez Trpimir” transportuan me ambulancë pesë pacientë në spitalin e Splitit. Në të njëjtën ditë ekuipazhet fluturuese të Skuadronit të 194-të

helikopterët të krahut të 91-të, transportuan një pacient në spitalin klinik në Rijeka. Aksionet filluan në mëngjes dhe vazhduan edhe gjatë natës, ku u transportuan me urgjencë: një qytetar gjerman dhe hungarez nga Hvar dhe Korčula, një banor kroat dhe dy turistë sllovenë nga

Hvar dhe Taolta. Gjatë këtij viti, ekuipazhi i fluturimit të Forcave Ajrore të Kroacisë nga Skuadroni 395 i Transportit të Helikopterëve, nga Divulje dhe ekuipazhi i fluturimit të Skuadronit të 194-të, transportuan gjithsej 378 pacientë gjatë 400 orëve të fluturimit.



# Veçori të Shtabit të Përgjithshëm gjatë LANÇ-it



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTA

## Veçori të shtabeve partizane

Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH u formua më 10 korrik të vitit 1943. Ai në punën dhe veprimtarinë e tij shfaqti disa veçori në vlerat dhe rolin drejtues të madh në organizimin dhe drejtimin e formacioneve partizane gjatë LANÇ-it. Në luftën partizane komandat e formacioneve ushtarake në veprimtarinë e tyre kanë pavarësi më të madhe, se ato që veprojnë në front të rregullt. Kjo është një veçori që njësitë partizane përhapen në hapësira të mëdha, të shkëputura nga njëra-tjetra, me mjete ndërlydhe të thjeshta, të pajisjes me armatim të lehtë, si dhe të bazave të furnizimit të sigurta në popullatë.

Veçori në fazën e parë të formacioneve partizane, ishin çetat e batalionet, që krijoheshin dhe vepronin brenda një qarku të caktuar dhe veprimtaria e tyre luftarake drejtohej nga komiteti i partisë i qarkut. Ndodhën edhe raste kur disa qarqe bashkëvepruan për plotësimin e një detyre të rëndësishme luftarake. Me rritjen e formacioneve partizane dhe të përmasave të luftës, në verën e vitit 1943, krijimi i SHP shtrohej si detyrë urgjente.

Veçori tjetër është se Shtabi i Përgjithshëm u zgjodh nga Këshilli i Frontit Nacionalçlirimtar, ku rëndësi të veçantë ju kushtua përzgjedhjes së anëtarëve të këtij shtabi. U zgjodhën anëtarë me arsim ushtarak, të shkolluar dhe të karrierës ushtarake si Spiro Moisiu, Abaz Kupi, Dali Ndreu, Bedri Spahiu, ku komandant i shtabit u zgjodh Spiro Moisiun, me gradën e majorit dhe funksionin e komandantit të batalionit në ushtrinë mbretërore. Ai kishte përvojë në detyrë ushtarake, një karrierë të gjatë, ku shqueshin aftësitë e profesionit ushtarak, si dhe dinjiteti e atdhedashuria. Intelektualët u përfaqësuan nga Ymer Dishnica, Sejfulla Malëshova, Enver Hoxha, Mustafa Gjinishi dhe Ramadan Çitaku, ku Enver Hoxha ishte sekretar i parë i PKSH dhe zgjidhet komisar politik. Anëtarë u zgjodhën dhe prijësa popullorë si Myslim Peza, Haxhi Lleshi e Mustafa Xhani, ky i fundit klerik, që me kohë krahinat e tyre Pezën, Dibërën e Martaneshin i kishin kthyer në baza të fuqishme të luftës së armatosur. Të gjithë anëtarët e shtabit formonin portrete ku secili me veçoritë e veta, me tipare të ndryshme, shqueshin për aktivitet të pasur patriotik e mbartnin një varg kualitetesh.

## Shtab drejtues dhe organizues në rang kombëtar

Krijimin e shtabit e kushtëzonte, por dhe e favorizonte, faktori i brendshëm dhe i jashtëm. Zgjerimi dhe zhvillimi i luftës së armatosur, rritja e formacioneve partizane për të kryer operacione të rëndësishme, kërkonte nga shtabi plotësimin e disa detyrave, si dhe të parashikonte zhvillimin e mëtejshëm të luftës. Në planin e jashtëm tërheqin vëmendjen fitoret e mëdha të arritura nga Ushtria Sovjetike në betejën e Stalingradit dhe nga forcat anglo-amerikane në Afrikën e Veriut dhe në Sicili. Kështu LANÇ-i, si pjesë përbërse e luftës antifashiste botërore, mundi të bashkërendohej me luftën e popujve pjesëtarë të kualicionit botëror vetëm me një shtab drejtues në shkallë kombëtare. Detyrat e shtabit ishin të gjithëanëshme. Detyra e parë themelore ishte organizimi i ushtrisë, përcaktimi i parime themelore, si parimi i vullnetarizmit. Zbatimi i këtij parimi kishte baza të shëndosha, që shprehej në rreshtimin vullnetar të qindra e mijra luftëtarëve në formacionet partizane.

Vëmendje i kushtoi shtabi ndërtimit të formacioneve të ushtrisë, parë kjo në kushtet e luftës partizane, të traditave luftarake të popullit tonë, të karakterit malor të terrenit dhe të zbatimit të parimit të autonomisë e lehtësisë në lëvizje. Brigada sulmuese i plotësonte kërkesat e këtij parimi. Brigada ishte njësi luftarake operative në dorë të shtabit. Ajo ishte e destinuar për të manovruar në varësi nga situata dhe për të plotësuar detyrat luftarake. Brigada do të përbëhej nga forca këmbësore dhe sasi e kufizuar artilerie të transportueshme me krahë e me kafshë. Brigadës i kërkoheshin lëvizshmëri e lartë dhe t'i përshtatej terrenit malor, por të zotëronte forcë goditëse e mëvetësi veprimi.

Shtabi u kujdes për të gjitha problemet që lidheshin me krijimin e organizimin e brigadave. Anëtarët të tij kryen në praktikë veprimtari intensive për kapërcimin e vështirësive që lidheshin me krijimin e tyre. Për periudhën gusht 1943 mars 1944, u krijuan shtatë brigada sulmuese që u komanduan nga Mehmet Shehu, Beqir Balluku, Hulusi Spahiu, Nexhip Vinçani, Shefqet Peçi, Tahi Kadare e Gjin Marku, të gjithë me shkollë ushtarak, me përvojën të pasur luftarake. Procesi vijoi dhe gjatë muajve prill-nëntor 1944, ku kemi 17 brigada, gjithsej 24 brigada sulmuese. Mbi bazën e brigadave në muajt maj-nëntor 1944 u krijuan

divizione dhe komparmata. Ky ishte organizimi i plotë i UNÇSH.

Por nuk ishte e thjeshtë të krijoheshin dhe organizoheshin një brigadë sulmuese. Ishte i lehtë caktimi i datës, vendi i grumbullimit, organizimi dhe përurimi, por duheshin zgjidhur një varg detyra, si sigurimi dhe kompletimi i brigadës me efektiv, problemi i kuadrit, sigurimi i armatimit e municioneve dhe pajisjeve, të merreshin masat për stërvitje, për përgatitje fizike dhe për edukimin moral të luftëtarëve.

## Taktikat e luftimit

Përpunimi i taktikës së luftimit ishte një detyrë e rëndësishme e shtabit, që ndikonte në ecurinë e veprimtarisë luftarake të formacioneve partizane. Kishte një bazë e mirë e taktikës së luftës partizane edhe para krijimit të shtabit. Taktika e luftës u përpunua dhe u zbatua në beteja me pjesëmarrjen aktive të luftëtarëve të thjeshtë dhe të kuadrove. Meritë të veçantë ka dhe shtabi, i cili motivoi nga përvoja elementet më pozitive të taktikës së luftës, i përpunoi në një kod taktik efektiv dhe nëpërmjet udhëzimeve, i përgjithësoi dhe i përhapte në ushtri.

Shtabi i Përgjithshëm me organizimin e ushtrisë, përsosi taktikën e luftës partizane në formacione të vogla, si dhe përpunoi metoda të përdorimit të grupeve partizane dhe të brigadave sulmuese. Këto mundësuan plotësimin e detyrave të rëndësishme, goditje të garnizoneve të mëdha të armikut, ndeshje të formacioneve të tij, luftimin për pushtimin e rajoneve të fortifikuara, për mësymjen në qytet etj.

Duke ndjekur ecurinë e veprimtarisë luftarake me trupat gjermane, shtabi vuri re aftësitë e këtyre trupave për të përdorur taktikën e luftës kundërpantizane dhe epërsitë që siguruan ata në operacionet e para. Shtabi reagoi me shpejtësi ndaj këtyre epërsive të artit ushtarak gjerman, evidentoi mangësitë e shfaqura nga disa formacione partizane dhe përcaktoi rrugët për t'u kundërvënë. Analiza e këtyre mangësive dhe kritika e të metave, ndihmoi në nxjerrjen e mësimet për të gjitha formacionet partizane. Krahas kritikës, shtabi bëri përgjithësime me vlera të mëdha për të përsosur taktikën partizane, duke u mbështetur në përvojën e fituar. Këto tipare pozitive të taktikës partizane, shtabi i përcillte në udhëzime për t'u rrënjësuar në praktikën e organizimit e të drejtimit dhe në veprimtarinë luftarake të çdo komande e reparti partizan. Urdhërat dhe udhëzimet

e dhëna nga shtabi, për taktikën e luftës partizane dhe zbatimin e tyre me krijimtari në fushën e betejës, pati ndikim të fuqishëm në rritjen e efektivitetit të veprimtarisë luftarake. U rritën ndjeshëm përmasat e veprimeve luftarake në kohë e në hapësirë. Luftime e përqëndruara në një ide të vetme i shkaktuan armikut humbje të ndjeshme dhe u arrit çlirimi i zonave dhe të krahinave.

Çlirimi i krahinave dhe lufta për çlirim dhe qyteteve, shtroi çështjen e taktikës së luftës ballore, një formë lufte thujse e panjohur për formacionet partizane. Shtabi u tregua tepër i kujdesshëm. Në vartësi nga situata dhe objekti i sulmit, shtabi vlerësonte të përshtatshme ndërthurjen e dy taktikave. Në operacionet mësymse për çlirim dhe krahinave malore, shtabi udhëzonte komandat e reparteve që krahas metodave të luftës partizane, duhej të shtonin kujdesin në përvetësimin e elementeve të taktikës ballore. Tipare taktika e luftës ballore po merrte në veprimet luftarake për çlirim dhe qyteteve. Mbështetur në detyrat e shtruara nga shtabi për çlirim dhe qyteteve, komandat e njësitë përpunuan, përgatitën e stërvitën trupat për luftime në qytete, me rëndësi taktikës së luftës ballore. Goditjet koncentrike, mësymja në ballë të gjerë, ngushtimi shkallë shkallë i unazës së rrethimit, luftimet vendimtare në brendësi të qytetit, sipas porosive të shtabit ishin disa nga dukuritë e veprimeve luftarake. Në luftën për çlirim dhe Tiranës, taktika e luftës ballore arriti shkallën më të lartë të saj. Lufta u bazua në planin e hartuar nga komanda dhe shtabi i zbatuar me përpikmëri nga komandat e të gjitha rangjeve. Efektivat e ushtrisë në luftë me armikun për 19 ditë rresht, manifestuan heroizëm e moral të lartë, aftësi e mjeshtëri në luftime të afërta, në veprime luftarake për pushtimin dhe mbajtjen e ndërtesave, të kryqëzimeve e të rrugëve, të objekteve të fortifikuara etj.

## Shtabi i Përgjithshëm institucion politik-ushtarak

Detyrë e rëndësishme e shtabit ishte drejtimi i drejtpërdrejt i veprimtarisë luftarake të njësitë të UNÇSH-së. Natyra e luftës partizane ishte e tillë që kërkonte nga komandantët e formacioneve partizane të kishin pavarësi njësitë që veprojnë në front të rregullt. Urdhërat luftarake shtabi nuk i jepte të prerë, por në formë direktive. Komandantët e reparteve e të njësitë udhëzoheshin të zgjidhnin vet objektivat, të godisnin, duke vepruar me shpirt krijues,

duke gjetur rrugë e forma efektive për zbatimin e detyrës së dhënë.

Por pavarësia që u lejohej komandave të formacioneve partizane ishte relative. Në urdhërat e veprimit komandave u përcaktohej rajoni ku do vendoseshin, objektivat e armikut në atë rajon, si dhe rrugët e komunikacionit që do mbanin në kontroll. Segmentin e rrugës ku do organizonin pritën apo goditjen, forcat që do përdornin dhe kohën e zënies së pitës, i përcaktonin vet komandat e njësitë. Shtabi u jepte komandave të njësitë urdhrin e çvendosjes nga një rajon në një rajon tjetër në vartësi nga prespektiva e zhvillimit të situatës.

Anëtarë të shtabit gjendeshin bashkë me komandat e njësitë, analizonin gjendjen e përcaktonin detyrat. Brenda këtyre kornizave shtrihej nisma e pavarësisë e komandave të formacioneve partizane, veprimtaria e të cilave nuk mund të dilte jashtë urdhërave e direktivave të shtabit. Duke parë e vlerësuar rolin e shtabit si institucion i rëndësishëm politik-ushtarak për organizimin dhe drejtimin e formacioneve të UNÇSH. Me krijimin dhe veprimtarinë e tij, lufta e armatosur e popullit shqiptar, hyri në një etapë të zhvillimit dhe mori karakter më të organizuar. Udhëheqja strategjike e operative e UNÇSH u ngrit në një shkallë më të specializuar. Në përballimin e operacioneve kryesore mësymse të nazistëve, shtabi çështjen e hartimit të planeve, organizimin dhe kryerjen e zbulimit strategjik, krijimin dhe përdorimin e rezervave etj.

Shtabi u krijua në një moment shumë të rëndësishëm për ecurinë e LANÇ-it. Në aspektin politik shtabi ishte në vartësi të drejtpërdrejt të KQ të PKSH. Tetë nga 12 anëtarët e SHP ishin anëtarë të PKSH, shumica në funksione drejtuese në organet qendrore apo lokale, ndërsa komisar i shtabit ishte njëherazi edhe sekretar i parë i PKSH. Prezenca në shtab e shumicës dërmuese nga përfaqësuesit e PKSH e lidhte tërësisht shtabin si në aspektin politik e ideologjik, ashtu edhe në aspektin organizativ me PKSH.

Shtabi u krijua me vendim të Këshillit të Përgjithshëm ANÇ, në veprimtarinë e këtij shtabi, këshilli s'kishte asnjë funksion. Këto organe kishin vetëm marrëdhënie bashkëpunimi. Në fushën e betejave anëtarët e shtabit, si edhe masa e kuadrove drejtuese të formacioneve të UNÇSH, shpalosën aftësi e merita, përballuan vështirësi të panumërta.





## BATALIONI II I KËMBËSORISË

# Përfundon qitja luftarake për 6-mujorin e parë

**B**azuar në plankalendarin e veprimtarive kryesore për vitin 2020, Batalioni II i Këmbësorisë zhvilloi qitje luftarake me armët e këmbësorisë. Kjo qitje u zhvillua më 2 korrik në përfundim të 6-mujorit të parë dhe ka për qëllim testimin e aftësive operacionale të repartit. Këto qitje u zhvilluan ditën dhe natën me qëllim testimin e personelit në qitje në kushte normale dhe në kushtet e pamjes së kufizuar. Përpara zhvillimit të qitjeve u zhvillua njohuri armatimi, mbërthim-zbërthim armësh, koalidim dhe qitje. Qitjet luftarake zhvillohen në çdo repart të Forcë Tokësore në përfundim të çdo gjashtë mujori.

